totali		160,235		2.79%		0.4	1.2	0.4	0.2	4	0.6	64,094	192,282	192,282		64,094	2,404	16	150



5. ZONA MIKSE – shërbimet përcjellëse (ZM)

Zona mikse - shërbimet përcjellëse (ZM) përmbanë 8 blloqe urbane (ZM-1-ZM-8) me sipërfaqe të përgjithshme prej **21.6 ha** ose 3.8% e totalit.




Fig. 11 Zona mikse

Zona mikse – shërbimet përcjellëse (ZM) përmbanë:

1. **Shërbimet përcjellëse për industri dhe ekonomi:**
 - Banka, posta, QMF, etj.
2. **Industrië terciare** (sipas ëikipedia.org) –
 - Terciare – sektori i shërbimeve / industria e shërbimeve ose ekonomia “e butë”, si shërbimet tregtare, zejtare, depotë e mallërave, shërbimi i ambalazhimit etj.
3. **Banim** (max. 60% e sipërfaqes së bllokut):
 - Privat - Individual dhe shumëbanesor
 - Hotelier si dhe konvikte banimi.
4. **Hapësirë e lirë / Përmbajtje publike**
 - a. Shesh
 - b. Fushëlojë për fëmijë
 - c. Parking
 - d. Këndi për mbeturina / shporta bërllogu
 - e. Park /Këndi për pushim - me gjelbërim të ulët dhe të lartë.

Kushtet: secili bllok apo nënbllok duhet të ketë përmbajtjet e sipërshënuara publike konform kapaciteteve të bllokut, respektivisht numrit të banorëve / shfrytëzuesve dhe standardeve ndërkombëtare për përmbajtje publike në zona me destinim të tillë.



Parametrat e ndërtimit të kësaj zone janë për çdo bllok në tabelën në vijim:

	nr.	Sip. Neto (m ²)	Sip parcelës (m ²)	Perqindja %	Qellimi i perdorimit	ISHP	ISD	ISG	shtigje/ parking	numri i etazheve	bodrumi	Sip. Perdhese (m ²)	Sip ndertimi (m ²)	S. Komerc. (m ²)	S. Banimi në Etazhe (m ²)	Gjelberim (m ²)	Nr. Punëtorëve /Banoreve	Nr. i parc. industriale /komerciale	Nr. Ban/Ha
Zona Mikse	01	16,487	5,000		mikse -kryesisht komerciale	0.4	1.8	0.4	0.2	5	0.5	6,595	29,677	17,806	11,871	6,595	568	6	
	02	29,749	5,000		mikse -kryesisht komerciale	0.4	1.8	0.4	0.2	5	0.5	11,900	53,549	32,129	21,420	11,900	1,024	7	
	03	34,649	5,000		mikse -kryesisht komerciale	0.4	1.8	0.4	0.2	5	0.5	13,859	62,367	37,420	24,947	13,859	1,193	5	
	04	24,764	5,000		mikse -kryesisht komerciale	0.4	1.8	0.4	0.2	5	0.5	9,905	44,574	26,745	17,830	9,905	852	7	
	05	33,322	5,000		mikse -kryesisht komerciale	0.4	1.8	0.4	0.2	5	0.5	13,329	59,980	35,988	23,992	13,329	1,147	6	
	06	29,010	5,000		mikse -kryesisht komerciale	0.4	1.8	0.4	0.2	5	0.5	11,604	52,218	31,331	20,887	11,604	999	5	
	07	23,084	5,000		mikse -kryesisht komerciale	0.4	1.8	0.4	0.2	5	0.5	9,234	41,552	24,931	16,621	9,234	795	5	
	08	25,014	5,000		mikse -kryesisht komerciale	0.4	1.8	0.4	0.2	5	0.5	10,005	45,024	27,015	18,010	10,005	861	43	
totali		216,079		3.76%		0.4	1.2	0.4	0.2	5	0.5	86,431	388,941	233,365	155,577	86,431	7,439	83	344



6. ZONA BANIMI – Mikse me shërbimet përcjellëse (ZBm)

Zona e banimit Mikse **ZBm** përmbanë 9 blloqe urbane (ZB-1-ZB-18) me sipërfaqe të përgjithshme prej prej **34.1 ha** ose 6.0% e totalit.




Fig. 12 Zona Banimi-Mikse

Zona e Banimit Miks – (ZBm) përmbanë:

1. **Banim** – 60% e sipërfaqes së ndërtuar
 - a. Objekte të banimit shumëbanesor;
 - b. objekte përcjellëse për nevojat e banimit, etj.
2. **Afarizëm** – 40% e sipërfaqes së ndërtuar
 - a. Afarizëm në përdhese të objekteve të banimit

Kushtet: Afarizmi në zonë banimi nuk guxon të:

- shkaktojë dëme në rrethinë dhe mjedis;
- paraqet rrezik (zjarri, eksplozimi, ndotje etj.) për banorët;
- shkaktojë zhurmë më shumë se 45 db – natën dhe 55 db –ditën
- ndikojnë negativisht në cilësinë e banimit, jetës dhe karakterit të bllokut.

Funksionet e lejuara janë: Ndërmarrje tregtare, Ndërmarrje zejtare, Ndërmarrje shërbyese, Ndërmarrje–organizata private arsimore/ shëndetësore / kulturore etj. që nuk cenojnë kushtet e sipërshënuara dhe posedojnë licencë për veprimtari përkatëse.

3. Hapësirë e lirë / Përmbajtje publike

- Gjelbrim i ulët dhe i lartë.

Hapësirat e lira janë përgjegjësi e pronarit (banorit) dhe realizohen brenda parcelës private.



Parametrat e ndërtimit të kësaj zone janë për çdo bllok në tabelën në vijim

	nr.	Sip. Neto (m ²)	Sip parcelës (m ²)	Perqindja %	Qellimi i perdorimit	ISHP	ISD	ISG	shtigje/ parking	numri i etazheve	bodrumi	Sip. Perdhese (m ²)	Sip ndertimi (m ²)	S. Komerç. (m ²)	S. Banimi në Etazhe (m ²)	Gjelberim (m ²)	Nr. Punëtorëve /Banoreve	Nr. i parc. industriale /komerciale	Nr. Ban/Ha
Zona Banimi Mikse ZBm	01	65,419			mikse - kryesisht banim	0.4	2.4	0.4	0.2	6	0.5	26,167	157,004	62,802	94,203	26,167	4,504	0	
	02	25,584			mikse - kryesisht banim	0.4	2.4	0.4	0.2	6	0.5	10,234	61,402	24,561	36,841	10,234	1,761	0	
	03	58,947			mikse - kryesisht banim	0.4	2.4	0.4	0.2	6	0.5	23,579	141,473	56,589	84,884	23,579	4,059	0	
	04	42,312			mikse - kryesisht banim	0.4	2.4	0.4	0.2	6	0.5	16,925	101,550	40,620	60,930	16,925	2,913	0	
	05	48,222			mikse - kryesisht banim	0.4	2.4	0.4	0.2	6	0.5	19,289	115,733	46,293	69,440	19,289	3,320	0	
	06	10,069			mikse - kryesisht banim	0.4	2.4	0.4	0.2	6	0.5	4,027	24,165	9,666	14,499	4,027	693	0	
	07	25,607			mikse - kryesisht banim	0.4	2.4	0.4	0.2	6	0.5	10,243	61,456	24,582	36,873	10,243	1,763	0	
	08	18,164			mikse - kryesisht banim	0.4	2.4	0.4	0.2	6	0.5	7,266	43,594	17,438	26,156	7,266	1,251	0	
	09	46,760			mikse - kryesisht banim	0.4	2.4	0.4	0.2	6	0.5	18,704	112,224	44,889	67,334	18,704	3,219	0	
totali		341,083		5.94%		0.4	2.4	0.4	0.2	6	0.5	136,433	818,600	327,440	491,160	136,433	23,484	0	689



7. ZONA E SHIRITAVE MBROJTËS TË GJELBËRIMIT (E)

Është menduar që lagja "Zona Ekonomike"si në Zonën Industriale si në Zonën Ekonomike të ketë shkallë minimale të ndotjes. Prandaj është paraparë shiriti mbrojtës i gjerësisë minimale.

Përgjatë rrugës regjionale M2 si dhe përgjatë Unazës është paraparë që të ketë shirit mbrojtës me gjelbërim të lartë të gjerësisë prej 22m në të dy anët e rrugës.




Fig. 13 Shiriti mbrojtës përgjatë Unazës së brendshme

Poashtu përgjatë rrugës së kategorisë 2-të brenda lagjes (rruga paralele me Unazë) duke kufizuar zonën ekonomike dhe industriale në anën verilindore, lindore, dhe jugore, poashtu në të dy anët e rrugës është paraparë shiriti mbrojtës i gjerësisë 22m. Kufiri Verior, Lindor, Jugor dhe Perëndimor i lagjes përshkohet me shiritin mbrojtës me gjerësi 22m që e izolon lagjen dhe mbron rrethinën.

Përgjatë trasesë së Autostradës Ibrahim Rugova është paraparë i tërë brezi mbrojtës të jetë i gjelbëruar sipas planit të autostradës.

Në këtë kategori futen të gjitha hapësirat e gjelbëruara, tamponet mbrojtëse rreth rrugëve, në mes të zonave etj.

Në këtë sipërfaqe nuk përfshihet gjelbërimi brenda blloqeve që është i dhënë vecant për çdo bllok në parametrat e blloqeve.

Zona mbrojtëse e gjelbërimit përmbanë 47 blloqe (E1-E-47) me sipërfaqe totale 58.3 ha ose 10.3% të totalit të sipërfaqes.




Fig. 14 Tërësia E – gjelbërim mbrojtës



- **ENERGJIA DHE INFRASTRUKTURA (EI)**

Instalimet elektrike

Trafostacioni qendror i ri parashihet të vendoset në zonën ekonomike në bllokun B27

Linjat ekzistuese të largpërquesve të tensionit të lartë 110 kV, që kalojnë nëpër blloqet, mbrohen me zona mbrojtëse nga ndërtimet dhe pengesat tjera në të ardhmen. Si version i dytë parashihet futja nëntokë në trasenë e re.

Instalimet hidroteknike

Kanali Ibër-Lepenc parashihet të futet në gypa nëntokësore dhe të eliminohet nga sipërfaqja e zonës përmes sistemit "sifon". Kanali i hapur brenda kufijve të lagjes del jashtë përdorimit dhe mund të tjetërsohet.

Në bllokun B20 në afërsi të udhëkryqit Unazë / Rruga tërthore parashihet stacion pompimi.

Rezervuarët e ujit për furnizim me ujë janë tre–dy prej tyre ekzistues, ku Rezervuari i Arbërisë ndodhet jashtë zonës ndërsa rezervuari Shkabaj ndodhet në bllokun A13. Rezervuari i ri i parapare kryesisht për Zonën Mikse – shërbimet përcjellëse është planifikuar poashtu të jetë jashtë zonës në lagjen Arbëria.


Instalimet e ngrohjes

Nënstacioni i ri / ngrohtorja e re parashihet të vendoset në zonën industriale në bllokun A11.

Poashtu gypat e lidhjes së Ngrohtores qendrore të qytetit me Termoelektranat në Obiliq kalojnë nëpër blloqet e Zonës Industriale.

Komunikacioni / Terminali i ri

"Zona Ekonomike" përkohësisht kryq e tërthor nga Rruga Regjionale M2 si dhe Unaza e jashtme. Duke qenë afër edhe autostradës si dhe hekurudhës, pozita e saj është shumë e volitshme për transportim të mallërave dhe produkteve për dhe nga zona në fjalë. **Stacioni qendror hekurudhor në Fushë Kosovë gjendet vetëm 5 km larg zonës ndërsa Aeroporti Ndërkombëtar Adem Jashari vetëm 10 km.** Megjithatë PrrU "Zona Ekonomike" sugjeron shqyrtimin e vendosjes së një **Terminal të ndërtuar enkas për shkëmbim të mallrave dhe deponim të përkohshëm** në afërsi të zonës e që mendohet se pozita më e mirë për këtë është hapësira e lirë ku zhvillohet aktualisht tregu i automjeteve në Zonën e Vjetër Industriale Prishtinë-Fushë Kosovë.



3.4 VIJAT RREGULLATIVE TË RRUGËVE DHE SIPËRFAQEVE PUBLIKE SI DHE VIJAT NDËRTIMORE

Planifikimi i ngastrave dhe objekteve në lagje varet nga lokacioni dhe kushtet e përgjithshme të rregullimit.

Kushtet për planifikimin e lokacionit / ngastrës janë:

- vija rregullative;
- vija ndërtimore;
- raporti sipërfaqja e shputës/ sipërfaqja e lirë;
- lartësia dhe etazhiteti i ndërtesës (indeksi i ndërtueshmërisë);
- raporti në mes të ndërtesave;
- forma dhe madhësia e ngastrës;
- mundësia e organizimi të ndërtesës në ngastër;
- qasja në ngastër;
- hapësira e parkimit;
- hapësira e gjelbërimit;
- riparcelimi;

Këto karakteristika ndryshojnë varësisht prej llojit të veprimtarisë.

Vija rregullative ndanë rrugën e propozuar publike me vijën frontale të ngastrës. Ngastrat të cilat kanë qasje në rrugën publike janë të obliguar që ta ndryshojnë vijë e ngastrës e me këtë përcaktohet edhe vija rregullative e tyre.

- Vija rregullative është definuar me vijë të ndërprerë me ngjyrë të zezë.

Vija ndërtimore

Distanca e përcaktimit të vijës ndërtimore nga vija rregullative është:

- min. 15.0 m (në zonën Industriale)
- min. 10.0 m (në zonën Komerçiale)
- min. 5.0 m (në zonën Mikse)

Distanca mes vijës së rregullimit dhe asaj të ndërtimit është distanca mes ndërtesave dhe përcaktohet për të mundësuar insolim adekuat, lehtësi për qasje në rastet emergjente, zvogëlim të mundësisë së kalimit të zjarrit prej njërës ndërtesë në tjetrën (parandalimi I përshkallëzimit të fatkeqësisë me efekt domino).

- Thellësia e ndërtesës pas vijës ndërtimore varet prej destinimit të objektit.
- Ndërtimi është i lejuar vetëm pas vijës ndërtimore. Tejkalimi i elementeve të ndërtesës si strehat, ballkonet, etj, mbi katin përdhësë mund të shkojnë deri në 1.4 metra;
- Vija ndërtimore në pjesën grafike është definuar me vijë të ndërprerë me ngjyrë të kuqe.



3.5 PIKAT E LARTËSISË SË RRUGËVE DHE SIPËRFAQEVE PUBLIKE (PLANI I NIVELIMIT)

Plani i nivelimit përcakton lartësitë niveluese të rrugëve dhe sipërfaqeve publike të planifikuara në raport me nivelimin ekzistues të terrenit dhe rrugëve ekzistuese. Lartësitë e dhëna të nivelit të rrugëve të planifikuara kanë karakter orientues dhe janë të mundshme përmirësimet në zgjidhjen teknike gjatë realizimit të rrugëve në terren.

3.6 ZGJIDHJA E RRJETIT TË INFRASTRUKTURËS

3.6.1 RRJETI RRUGOR - TRANSPORTI

Lagja "Zona Ekonomike" ndodhet në një distancë jo të largët nga zona qendër e qytetit.

3.6.1.1 Zgjidhja e udhëkryqeve problematike



Fig. 15 Udhëkryqi 1

Udhëkryqi 1	Rruga Qarkore	Rruget e Zonës
Dimensionet	Dy shirita qarkullues dhe një shirit ndihmës (emergjent) për secilën kahje. Shiritat Qarkullues me dim >4m	Përbëhen nga dy shirita qarkullues, secilën kahje nga një me dim min>3.0 m
Kapaciteti	C>1000 Au/h	C=600 Au/h
Forma e pikëprerjes	Udhëkryq klasik +	Udhëkryq klasik +
Prioriteti	Rrugë me prioritet	Rrugë sekondare në raport me rrugën qarkore
Forma e rregullimit të qarkullimit	Fillimisht deri në rritjen e qarkullimit në masën 50% nga kapaciteti i paraparë për rruget që kycen nga Zona Ekonomike, rregullimi mund të bëhet përmes dhënies së prioritetit rrugës qarkore. Me rritjen e qarkullimit nga rrugët anësore (Zonës ekonomike), rregullimi i qarkullimit të bëhet përmes sinjalzimit ndriçues – semaforëve, kur si prioritet	



	mbetet qarkullimi i automjeteve nga rruga qarkore. Në planin afatgjatë propozohet që të aplikohet mbikalimi i formës së paraqitur në skemën b dhe në situacionin e rrugëve.
--	--




Fig. 16 Udhëkryqi 2

Udhëkryqi 2	Rruga Qarkore	Rrugët e Zonës
Dimensionet	Dy shirita qarkullues dhe një shirit ndihmës (emergjent) për secilën kahje. Shiritat Qarkullues me dim. >4m	Përbëhen nga dy shirita qarkullues, secilën kahje nga një me dim min>3.0 m
Kapaciteti	C>1000 Au/h	C=600 Au/h
Forma e pikëprerjes	Udhëkryq klasik +	Udhëkryq klasik +
Prioriteti	Rrugë me prioritet	Rrugë sekondare në raport me rrugën qarkore
Forma e rregullimit të qarkullimit	Fillimisht deri në rritjen e qarkullimit në masën 50% nga kapaciteti i paraparë për rrugët që kyçen nga Zona Ekonomike, rregullimi mund të bëhet përmes dhënies së prioritetit rrugës qarkore. Me rritjen e qarkullimit nga rrugët anësore (Zones ekonomike), rregullimi i qarkullimit të bëhet përmes sinjalzimit ndriçues–semaforëve, kur si prioritet mbetet qarkullimi i automjeteve nga rruga qarkore. Në planin afatgjatë propozohet që të aplikohet mbikalimi i formës së paraqitur në skemën b dhe në situacionin e rrugëve.	





Fig. 17 Udhëkryqi 3



Udhëkryqi 3	Rruga Qarkore	Rrugët e Zones
Dimensionet	Dy shirita qarkullues dhe një shirit ndihmës (emergjent) për secilën kahje. Shiritat Qarkullues me dim. >4m	Përbehen nga dy shirita qarkullues, secilën kahje nga një me dim min>3.0 m
Kapaciteti	C>1000 Au/h	C=600 Au/h
Forma e pikëprerjes	Udhëkryq klasik T	Udhëkryq klasik T
Prioriteti	Rrugë me prioritet	Rrugë sekondare në raport me rrugën qarkore
Forma e rregullimit të qarkullimit	Ky lloj i kryqëzimit shërben kyçjen dhe çkyçjen nga rruga qarkore në vetëm një drejtim (krahu djathtas), gjë që nuk paraqet ndonjë ngecje të trafikut. Rregullimi i qarkullimit në keto udhëkryqe të bëhet përmes prioritetit, ku prioriteti i jepet rrugës qarkore.	



3.6.1.2 Kategorizimi i rrugëve

Kemi disa rrugë shumë të rëndësishme që prekin apo përshkojnë lagjen "Zona Ekonomike" si: Autostrada, Magjistranja Prishtinë-Mitrovicë dhe Unaza e Brendshme dimensionet dhe kapacitetet e të cilave janë marrë nga projektuesit e tyre.

Në vijim shpjegohen kategoritë e rrugëve të reja të propozuar në këtë plan:

Kategoria I

Rrugë e kapacitetit më të lartë në kuadër të rrugëve urbane, të cilat tregojnë një ngarkesë trafiku të mesme-të lartë, të cilat kanë funksionet e mëposhtme: lidhin zonën me zonat tjera përreth, qendrën e qytetit dhe rrugët tjera me hyrje për në qendër, kalojnë në pjesë më të rëndësishme të zonës, lidhin direkt njësitë e ndryshme të zonës me qëllim që rrjeti në tërësi të jetë sa më efikas.

Profili: trotuar / gjelbërim / shirit 2 korsi / gjelbërim / shirit 2 korsi / gjelbërim / trotuar




Fig. 18 Profili i rrugës kategoria I

Kategoria II

Rrugë urbane me kapacitet të mesëm, me funksionet e mëposhtme: mbledhjen/shpërndarjen e trafikut ndërmjet rrugëve primare dhe linjat me kapacitet të ulët të rrjetit, nën-lidhjet me rrugët tjera në kuadër të lagjes

Profili: trotuar / gjelbërim / shirit 2 korsi / trotuar / gjelbërim




Fig. 19 Profili i rrugës kategoria II

Kategoria III

Rrugët urbane me kapacitet më të ulët për një zonë të caktuar.

Profili: trotuar / shirit 2 korsi / trotuar




Fig. 20 Profili i rrugës kategoria III

Kategoria IV dhe IV'

Rrugët urbane me kapacitet të ulët me hyrje lokale për një zonë të caktuar.
 Profili: trotuar/ gjelbërim / shirit 2 korsi / gjelbërim/ trotuar




Fig. 21 Profili i rrugës kategoria IV

Distanca ndërmjet udhëkryqeve

Me rastin e projektimit të udhëkryqeve është e nevojshme të merret parasysh edhe distanca ndërmjet tyre. Distanca ndërmjet udhëkryqeve është në varësi të shpejtësisë projektuese dhe distancat minimale janë sipas tabelës në vijim:

V (km/h)	50	60	70	80	90	100
Distanca (m)	140	170	205	235	270	300

Tab. 4 Distanca ndërmjet udhëkryqeve


Për shpejtësi më të vogël se 50km/h (40 km/h) distanca minimale nuk duhet të jetë më e shkurtër se 100 m.

Rrezja e kthesës në udhëkryqe

Për kushte urbane, rrezja e kthesës në udhëkryqe është në varësi nga këndi i kryqëzimit të rrugëve si në tab.

Këndi i gërshetimit (°)	Radiusi kryesor
70	12
90	12(15)
110	8

Tab. 5 Këndi dhe radiusi i rrugëve



Duke analizuar rrezet në udhëkryqe të cilat kanë një radius prej 15m, rrjedh se në tërësi i plotësojnë kushtet për kthim, pavarësisht nga struktura e automjeteve në trafik.


Pjerrtësitë gjatësore

Pjerrtësia gjatësore maksimale nuk duhet të kalojë vlerën prej 11%. Duke pasur parasysh karakterin e zonës, e rekomanduar është 8-9% pjerrtësi gjatësore maksimale në intervale të shkurtëra të rrugës.

Në pjesët e rrugëve, ku kalohet kjo pjerrtësi, rregullimi mund të bëhet duke kombinuar mbushje dhe gjermim të trasës për të arritur pjerrtësinë e dëshiruar. Kuotat aktuale të prezentuara edhe në pjesën grafike paraqesin kuotat e terrenit.

3.6.1.3 Transporti Publik

Sipas linjave ekzistuese të transportit publik urban të udhëtarëve, "Zona Ekonomike" nuk është e përfshirë përmes ndonjë prej linjave. Por linjat që arrijnë deri në kufijt e zonës janë linja 6- përmes lagjes Arbëria dhe 6A nga drejtimi i varrezave të qytetit. Fillimisht për përmbushjen e kërkesave për qarkullim të udhëtarëve është shumë e përshtatshme krijimi i një linje radiale me bashkimin e linjave 6 dhe 6A duke kaluar nëpër Zonën ekonomike. Kjo linjë do të plotësonte kërkesën për udhëtim në drejtim të qendrës së qytetit. Për distanca më të largëta si dhe qasje ndaj formave tjera të transportit është e nevojshme edhe një linjë transporti përgjatë rrugës qarkore.



Linjat e transportit urban për qytetin e Prishtinës





Fig. 22 Rrjeti i trafikut urban në Prishtinë

Në afërsi të zonës me destinim industri, përgjatë trasës ekzistuese të hekurudhës, vendosja e një nënstacioni hekurudhor vetëm për mallëra është i mjaftueshem sa i përket kërkesës për këtë lloj transporti. Shërben si pikë ndërmjetëse nga terminali doganor – pjesa e hekurudhës e deri në destinimin final.



3.6.1.4 Qarkullimi i këmbësorëve

Karakteristikat primare të qarkullimeve të këmbësorëve në pjesën e rrugës për këmbësorë, për nga natyra janë të ngjashme me karakteristikat e qarkullimit të automjeteve në pjesën e rrugës.

Sikurse te qarkullimi i automjeteve, ekzistojnë indikatorë të shumtë të shkallës së mobilitetit për qarkullim të këmbësorëve në rrugët për këmbësorë.

Që të kompletohet kjo analizë e relacioneve themelore ndërmjet qarkullimit të këmbësorëve dhe hapësirës përkatëse në dispozicion për këmbësorë, duhet të analizohet gjerësia efektive e rrugës për këmbësorë.


Me qëllim të akomodimit dhe sigurisë së këmbësorëve, gjerësia e trotuarit në zona industriale është paraparë 2.0 m, ndërsa në zona banimi kjo gjerësi është paraparë 1.5 dhe 2.0 m. Prandaj, hapësira përkatëse në dispozicion për këmbësorë, do të jetë e mjaftueshme në raport me fluksin e paraparë të këmbësorëve.

Nga literatura profesionale distanca e lëvizjes deri në 150 metra, përmban 100% lëvizje të këmbësorëve në strukturën e përgjithshme të qarkullimit. Prandaj, aktivitetet e këmbësorëve realizohen kryesisht në distanca të vogla, gjë që edhe e rritë lëvizjen e tyre ndërmjet zonave.

Profili horizontal bazë për lëvizjen e këmbësorëve është definuar në bazë të karakterit të zonës, gjerësisë mesatare të supeve të këmbësorëve (0,60 m) dhe gjerësisë tërthore të trupit (0,40 m). Secili këmbësor ka nevojë për hapësirën manovruese për lëvizje të sigurt dhe të papenguar. Kjo hapësirë ndryshon varësisht nga mënyra se a është këmbësori në lëvizje apo është i ndalur.

Qarkullimi në vendkalimet e këmbësorëve paraqet numrin e këmbësorëve të cilët në njësi të kohës mund të kalojnë pjesën e caktuar të rrugës. Qarkullimi, i cili shfrytëzohet si parametër bazë për caktimin e gjerësisë së vendkalimit për këmbësorë, merret në konsideratë vetëm kur ekziston numër i madh i këmbësorëve. Qarkullimi i këmbësorëve në një kah sillet rreth 39-82 këmb/m/min, ndërsa për kushtet e qarkullimit urban qarkullimi sillet rreth 66 këmb/m/min.

Shtegu për këmbësorë mund të definohet si hapësirë për lëvizje të papenguar në shtegun për këmbësorë dhe lëvizje të papenguar në trafikun e këmbësorëve. Hapësira për lëvizje të papenguar në shtegun për këmbësorë përbëhet nga hapësira për trafik të papenguar dhe dy shiritat sigurie. Hapësira për trafik të këmbësorëve paraqet profilin tërthor të shtegut të këmbësorëve, i domosdoshëm për lëvizjen e këmbësorëve, derisa shiritat e sigurisë ofrojnë siguri dhe komoditet për lëvizjen e këmbësorëve.



3.6.2 RRJETI I UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMIT

3.6.2.1 Të përgjithshëm

"Zona Ekonomike" e Komunës së Prishtinës me sipërfaqe prej 620 ha në kontestin e infrastrukturës së ujit parqet një nyje kryesore përmes së cilës kalojnë dhe janë të vendosura disa prej objekteve kryesore të infrastrukturës së ujit. Duke përfshirë transportuesit kryesor të ujit të pijes, rezervuare dhe kalimin e kanalit për ujitje të tokave bujqësore ose kanali i Iber-Lepencit. Në shumë aspekte këto parqesin resurse dhe konsiderohen si përparësi për afrimin e shërbimeve, por gjendja e tanishme e shpërndarjes dhe shtrirjes në Zonën ekonomike të kësaj infrastrukture paraqet një dobësi në kuptimin e pengesës në zhvillimin e hapsirave brenda blloqeve të zonës. Për këtë arsye janë dhënë zgjidhjet që do të mundësonin edhe shfrytëzimin si resurse, dhe njëkohësisht edhe zvogëlimin e pengesave që paraqesin për zhvillimin e zonës.

3.6.2.2 Gjendja ekzistuese e Infrastrukturës së ujit të pijës dhe ujërave të zeza.

RRJETI I UJIT: Në zonën ekonomike dhe në periferinë e sajë është ndërtuar një infrastrukturë primare për furnizim me ujë të qytetit të Prishtinës dhe gjithashtu është në planifikim përfundimtarë fillimi i implementimit, të fabrikës së re të ujit të pijes për qytetin e Prishtinës. "Zona Ekonomike" përkohet dhe u afrohet gjashtë gypave primarë që përkohjnë Zonën ekonomike.

GYPAT:

- Gypi Batllavë (Fabrika e ujit –Rezervuari Arbëria dhe Kodra Trimave), DN-900 mm
- Gypi i ujit degëzimi Batllavë (Fabrika e ujit)- Rezervuari Arbëria DN-700
- Gypi i ujit degëzimi Batllavë (Fabrika e ujit)- Rezervuari Kodra e Trimave DN-600
- Rezervuari Arbëria-Rezervuari Shkabaj DN-400
- Rezervuari Shkabaj-Konuna Obiliq DN-500
- Rezervuari Shkabaj-Konuna Fushë Kosovë (Zona Industriale) DN-500

"Zona Ekonomike" nuk posedon ndonjë sistem shpërdatës të ujit të pijes ose janë në përmasa shumë të vogla ndërsa i vetmi rrjet që furnizon një pjesë të Zonës ekonomike dhe fshatin Shkabaj është gypi nga azbest çimentoja me DN-250 dhe një pjesë e të cilit është ndërruar me HDPE OD-250 mm.

Të gjithë këta gypa primarë janë nga materjali i çelikut dhe janë furnizuesit kryesor me ujë të qytetit të Prishtinës, Fushe Kosovës dhe Obiliqit. Të gjithë këta gypa duhet të mbeten në funksion derisa të arrihet ndërrimi i tyre, dhe vendosja e tyre në trasat e reja të dhënë në propozim. Propozohet që të koordinohen aktivitetet me KUR "Prishtina" për procesin e ndërrimit të tyre sipas planifikimeve që të vendosen në pozicionet që nuk pengojnë zhvillimin e zonës.

REZERVUARET: Brenda kufirit të Zonës ekonomike ndodhet njëri prej rezervuarve kryesor që furnizon me ujë komunat e Obiliqit, një pjesë të Prishtinës dhe një pjesë të Fushë Kosovës. Pozicioni i tij është në lokacionin e planifikuar si zona industriale dhe gjendet në kotën 605 m.n.d me një vëllim prej 10.000 m³. Gjithashtu Në kufijë të Zonës ekonomike ndodhen edhe dy rezervuare tjerë qëndrorë.

- Rezervuari i Arberisë me V=15.000 m³ dhe
- Rezervuari i Kodrës së Trimave me V=5.000 m³ dhe



KANALI I UJITJES "Zona Ekonomike" përkohet nga kanali i hapur nga betoni në formë trapezi me bazë $b_1=2\text{m}$ dhe $b_2=5\text{m}$ ndërsa lartësia $h=2\text{ m}$ me destinim ujitjen e tokave bujqësore në disa pjesë të Prishtinës dhe Graçanicës. Ky kanal ka patur një shfrytëzim shumë të vogël për destinimin e ujitjes edhe nga shkak që një pjesë e madhe e tokave bujqësore të planifikuara për ujitje në kohën e ndërtimit të kanalit me kalimin e kohës janë shëndërruar në toka ndërtimore. Dobësia e këtij kanali kundrejt Zonës ekonomike është se shtrirja e tij gjarpërore me një gjatësi prej 7.5 km, parqet një pengesë serioze për zhvillimin edhe të infrastruktures tjetër dhe zhvillimin e blloqeve për zonën ekonomike në tërësi. Zgjidhjet e propozuara janë dhënë në pjesën e konceptit zhvillimor për ujin e pijes dhe ujin teknikë.

RJETI I KANALIZIMIT . Sipërfaqja e madhe dhe topografia e zonës ekonomike parqesin një grumbullues natyrorë të ujërave sanitare të një pjesë të madhe të lagjës së Kodrës së trimave, Arbërisë dhe një kolektor natyror të thekësuar të ujërave të shiut. Infrastruktura nuk është e zhvilluar dhe praktikisht kjo zonë nuk posedon ndonjë infrastrukturë konkrete që mund të mbështetë të largimi i ujërave sanitare dhe atmosferike. Të vetmit kolektorë që marrin një pjesë, të ujërave sanitare dhe atmosferike janë në hyrje të lagjës Shkabaj dhe vazhdohet në një kolektorë të mbyllur me dy komora deri në kalimin e rrugës magjistrale Prishtinë-Mitrovicë. Brenda zonës egzistojnë edhe tri përrocka që shëbejnë si grumbullues-largues të ujërave Sanitare dhe atmosferike. Sasia e ujit atmosferik në total nga të tri përrojet është kalkuluar në bazë të projektit të Komunës për rregullimin e këtyre projeve. $Q=26.4\text{ m}^3/\text{sec}$ me dimensione $2.5 \times 2.5\text{m}$ të kanalit grumbullues të ujërave të shiut.

3.6.2.3 Koncepti i furnizimit me ujë të pijës dhe ujë teknikë bashkë me infrastrukturën ujore.

3.6.2.3.1 Furnizimi me ujin e Pijës

Përparësia e furnizimit me ujë të zonës ekonomike qëndron në faktin se zona është rrethuar dhe infrastrukturën kryesore, të furnizimit me ujë për qytetin e Prishtinës duke përfshirë rezervuarin e Arbërisë në kotën 650 m.n.d dhe rezervuarin Shkabaj në kotën 605 m.n.d si dhe në proces është fillimi i ndërtimit të fabrikës së re të ujit të pijës në Shkabaj.

Burimet kryesore për furnizim të ujit të pijës do të jenë, Liqeni i Batllavës dhe Liqeni i Gazivodës përmes rezervuarve ekzistues në Arbëri dhe Shkabaj. Dimensionimi i infrastrukturës shpërndarëse është konceptuar dhe furnizimi për tri zona të presionit.

- zona e parë (I) ose qëndrore nga kota 560-620 me furnizim nga rezervuari i Arbërisë
- zona e dytë (II) Zona veriore e Zonës ekonomike me kota 620-660 me furnizim përmes stacionit të pompave i vendosur në këtë zonë në kotën 600 m.n.d
- zona e tretë (III) ose zona jug-perëndimore në kotat 625-660 me furnizim nga gypi ekzistues nga Kodra e Trimave DN-250.

Infrastruktura e planifikuar është projektuar të përballojë kërkesat për ujë të pijës deri në $Q=300\text{ l/sec}$ për një periudhë më të gjatë se 35 vjet. Gjatësia totale e rrjetit primarë dhe sekondarë në gjatësi totale prej $L=57\text{ km}$ të profileve

DN-400 $L=4.5\text{ km}$

DN-250 $L=10.8\text{ km}$

DN-150 $L=10.7\text{ km}$

DN-100 $L=31.0\text{ km}$

Materjali i propozuar është paraparë të jetë nga HDPE.



Brenda Zonës ekonomike është planifikuar vendosja e një stacioni të pompave për rritjen e presionit për zonën e dytë me një sasi uji prej $Q=70$ l/sec dhe $H=60$ m. Për shkak të rëndësisë së veçantë që kanë objektet e zonës ekonomike dhe vlerës së lartë investive dhe rëndësisë që mund të kenë produktet veçanta është paraparë vendosja e hidranteve kundër zjarrit në një rreze 200 m.


Gjithashtu është paraparë krijimi i traseve të reja për çvendosjen e gypave ekzistues të ujit të pijës, që kalojnë nëpër zonën ekonomike dhe që pozicioni i tanishëm parqet pengesë për zhvillimin e zonës. Kjo do mund të implementohet paralelisht me zhvillimin e infrastrukturës rrugore, ndërsa deri në çvendosjen e tyre gypat kryesor duhet ruajtur nga procesi i dëmtimeve që mund të shkakëtohen nga ndërtimet në zonën ekonomike.

3.6.2.3.2 Furnizimi me ujin teknik

Me qëllim të ofrimit të ujit teknik për zonën ekonomike e konkretisht më shumë për zonën e veçantë të industrisë është planifikuar marrja e ujit të papërpunuar nga kanali i Ibër-Lepencit dhe trajtimi parapark përmes një trajtuesi që do të ofronte kualitetin e ujit në parametrat për kërkesat e zhvillimit industrial. Lokacioni i marrjes dhe trajtimit janë planifikuar në afërsi të vendit ku do ndërtohet fabriaka për trajtimin e ujit të pijës për qytetin e Prishtinës. Uji teknik do të transportohet nga një arterje kryesore paralel me unazën e qytetit që ndanë zonën ekonomike dhe një degë që transporton ujin deri te pjesa me destinim industrial. Diametri kryesorë është paraparë të jetë DN-300mm me një gjatësi totale prej $L=4200$ m dhe DN-250 me një gjatësi prej $L=4900$ m dhe sasi prej $Q=250$ l/sec. Rregullimi i marrjes së ujit dhe funksionimi i furnizimit të kanalit të Ibër-Lepencit nga stacioni i pompave në Besi deri në lokacionin për marrjen e ujit në Shkabaj duhet të bëhet përmes një marrveshje me Kompani Ibër-Lepenc që të mundësohet furnizimi i pandërprerë i kanalit me ujë dhe kualitet të caktuar.

3.6.2.3.3 Trajtimi i kanalit të hapur të Ibër-Lepencit

Kanali ekzistues në formë trapezi për ujitjen e tokave bujqësore me një gjatësi prej $L=7555$ m. përshkon në formë gjarpërore pjesën më të madhe të Zonës ekonomike dhe paraqet një pengesë në zhvillimin e infrastrukturës dhe zhvillimin e disa blloqeve të zonës ekonomike. Me qëllim që ky kanal të mos parqesë problem për zhvillimin e zonës është paraparë vendosja e një gypi të mbyllur nga fillimi i kanalit në hyrje të zonës deri në daljen e kanalit nga zona ekonomike. Kanali i propozuar do të egzekutohej në një trasë që do jetë e implementueshme dhe në kuptimin teknik, dhe në kuptimin hidraulik do të arrijte të përballonte një sasi që do të vazhdonte në kanal in e hapur me kanal in nga Zona ekonomike. Kanali i projektuar do jetë me një gjatësi prej $L=4400$ m, me diametër DN=1100 mm dhe $Q=1150$ l/sec.



3.6.2.4 Koncepti i furnizimit me ujë të pijës dhe ujë teknikë bashkë me infrastrukturën ujore.

3.6.2.4.1 Largimi i kanalizimit sanitarë.

Topografia e Zonës ekonomike mundëson shfrytëzimin e ramjës natyrore për largimin e ujërave të ndotura, si atyre sanitare dhe atyre atmosferike dhe atë në tri zona:

- Zona e parë (I) me sipërfaqe prej 710 ha
- Zona e dytë (II) me sipërfaqe prej 222 ha
- Zona e tretë (III) me sipërfaqe prej 135 ha

Projekti i Zonës ekonomike parashehë instalimin e sistemit të largimit të ujërave sanitare në dy drejtime, zona e parë dhe zona e tretë bëjnë largimin e ujrave të ndotura në drejtim të Obiliqit gjegjësisht në drejtim të dy prockave që do të transportojnë dhe një pjesë të ujërave të ndotura të lagjës Kodra e Trimave dhe Arbëria me destinim largimin në drejtim të sistemin e largimit të ujrave te zeza të përbashkët me Qytetin e Obiliqit, ndërsa zona e dytë në drejtim të zonës industriale të Fushë Kosovës.





Fig. 23 Orjentimi i largimit të ujërave të zeza nga Zona ekonomike

Gajtësia totale e kanalizimeve të planifikuar është $L = 52.9$ km ndërsa kanalizimit sipas diametarve është.

DN-500 $L = 4.7$ km

DN-400 $L = 4.2$ km

DN-300 $L = 44.0$ km



3.6.2.4.2 Largimi i kanalizimit Atmosferik

Topografia e Zonës ekonomike detyron largimin e ujërave atmosferik në konceptin e njëjtë si të ujërave sanitare në të tri zonat. Grumbulluesi më i madh i ujërave atmosferik është zona e parë me 710 ha që përshkon zonën ekonomike përmes dhe që paraqet edhe kolektorin kryesorë të zonës që vazhdon përmes fshatit Shkabaj në Komunën e Obiliqit dhe largohet në lumin Sitnica. Komuna e Prishtinës ka hartuar projektet për rregullimin e përrockave brenda kësaj zone por që përfshijnë edhe zonat tjera periferike siç është Kodra e Trimave dhe Arbëria. Kanali kryesor është planifikuar të jetë në formë katrori me 2.2×2.5 të perimetrit të lagur që mundëson largimin e $Q=26.4 \text{ m}^3/\text{sec.}$, ky paraqet kolektorin kryesor A. Kolektorët tjerë B dhe C propozohet që për arsye të shfrytëzimit sa më të mirë të zonës ekonomike të futën brenda sistemit të largimit të ujërave atmosferike nga "Zona Ekonomike" përmes vendosjes së gypave në rrugët e planifikuara. Kolektori grumbullues kryesor i planifikuar të mbetet i hapur do ketë gjatësinë 5000 m deri në fshatin Shkabaj. Rrjeti i largimit të ujërave të shiut përfshinë një gjatësi totale prej $L= 50.4 \text{ km}$. Të dhëna në profilet e mëposhtëme:

DN=400 mm L=39.0 km

DN=500 mm L=4.8 km

DN=600 mm L=3.5 km

DN=1000 mm L=3.1 km

Në dy pozicione të zonës është paraparë grumbullimi i një vëllimi të caktuar me nga 100 m^3 ujë të shiut që do të shërbente për destinime teknike siç janë rastet e ujitjes, pastrimit të rrugëve ose përdorimi në rastet e avarive dhe zjarreve.

3.6.2.4.3 Largimi i ujërave industrial .

Meqenëse një pjesë e lagjes "Zona ekonomike" është zonë industriale ujërat e përdorura nga kjo zonë janë planifikuar të jenë të veçanta në procesin e largimit dhe trajtimit të këtyre ujërave. Nga zona industriale sasia e ujit e paraparë rrethë 150 l/sec. do të nënshtrohet një trajtimi parapark para se ujërat industriale të bashkohen me ujërat sanitare për trajtimin e përgjithëshëm. Primare do jetë ndalja e undyrave, vajrave dhe metaleve para se këto ujëra të shkojnë në procesin e trajtimit bashkë me ujërat sanitare në derjtim të Obiliqit.



3.6.3 RRJETI ELEKTROENERGJETIK DHE TELEKOMUNIKUES

3.6.3.1 GJENDJA AKTUALE

Në aspektin e mirëmbajtjes së rrjetit si dhe furnizimit e konsumatorve me energji elektrike, i tërë *konsumi* i energjisë elektrik në Zonën Ekonomike në nivelin distributiv, menaxhohet dhe eksploatohet nga Distrikti i Prishtinës. Në aspektin e planifikimit të zgjerimit të rrjetit distributiv kjo njësi participon vetëm me shënimet nga tereni. Poashtu implementimin e projekteve të reja, kjo njësi punuese vetëm e garanton nga aspekti i sigurisë elektrike, si dhe merr pjesë në pranimet teknike të objekteve të reja për nivelin distributiv.

"Zona Ekonomike" furnizohet nga trafostacioni TS Prishtina 3 110/10 kV/kV me fuqi instaluese 2x31.5 MVA. Vlen të potencohet se siguria furnizuese në nivelin 110 kV relativisht është e kënaqshme, nga shkak se rënja e njëërës nga linjat 110 kV nuk shkakton pamundësinë e furnizimit kontinuel të Lagjes, pra plotësohet kriteri shumë i nevojshëm **n-1**.

Karakteristike për Zonën Ekonomike është se nëpër të kalojnë një numër i madh i largpërquesve të tensionit të lartë 110kV. Një numër i caktuar i objekteve është ndërtuar nën këta LP, përkundër rrezikut nga tensioni i lartë. Sipas rregullave përgjatë LP të tillë nuk guxon të ketë ndërtim urbanistik.


Në nivelin e tensionit të mesëm shumica e objekteve të instaluarat el. energjetike janë për tension 10kV. Linjat furnizuese të tensionit të mesëm të instaluarat para vitit 1999 janë të dimensionuara kryesisht për nivelin 10kV. Numri i TS të nivelit 10/0.4kV është i vogël sepse edhe numri i objekteve banimore dhe afariste është i vogël.

Ekziston një pjesë e linjave ajrore të montuara në shtylla të impregnuara të drurit (SHD), në shtylla të betonit (SHB), e në disa ekziston kombinim i tyre (SHBD). Në disa nga trasat e linjave 10 kV dhe 0.4 kV, me shtylla të drurit, lartësia e pëçuesve el. është e ulët, distanca me objektet e banimit, afariste dhe shoqërore e pamjaftueshme, kalimet në rrugë janë joadekuate, kështu që nuk i përmbushin kriteret nga aspekti i sigurisë.

Njësitë transformuese janë të tipit "blindë" TSMB. Gjendja teknike e këtyre objekteve në tërësi nuk është e mirë, nga fakti se shumica e tyre janë të vjetërsuara dhe jo të mirëmbajtura si duhet. Edhe këtu një pjesë e konsiderueshme e objekteve transformuese nuk posedojnë pajisje teknikisht në rregull, kështu që paraqesin rrezik për stafin operativ të mirëmbajtjes, e veqënisht për sigurinë e qytetarëve.

Mund të konstatohet se krijimi i rrjetit shpërndarës furnizues këtu është realizuar pa ndonjë analizë, sidomos në aspektin e optimizimit. Problem poashtu të theksuar paraqesin seksionet jo adekuate të përqesve të linjave 10kV-she në raport me gjatësitë e tyre dhe numrin e TS-ve të kyçura në to.

Sa i përket gjendja aktuale në infrastrukturën telekomunikative, pas lufte PTK ka shtrirë kanalizimin kablovik të ri të rrjetit telefonik i cili përmbushë plotësisht kërkesat momentale. Mirëpo ekzistojnë edhe rrjete të telekomunikacionit me kabllim mbitokësorë nëpër LP e tensionit të ulët të KEK-ut të instaluar nga kompanitë IPKO dhe Kujtesa.



3.6.3.2 PROPOZIMET TEKNIKE ELEKTRO ENERGETIKE DHE TE TELEKOMIT

Propozimet Teknike janë dhënë bazuar në procedurat bazike që aplikohen gjatë planifikimit urban të një SEE, e që janë:

1. Mbledhja e shënimeve për rrjetin ekzistues
2. Analiza e rrjetit ekzistues
3. Ngarkesa aktuale dhe ajo e parashikuar
4. Planifikimi optimal i lokacionit, madhësisë dhe zonës së TS 20/0.4kV.
5. Planifikimi i rrjetit distributiv 20kV.
6. Planifikimi i rrjetit distributiv 230/400V.
7. Analizat e rrjedhes së fuqisë.
8. Analizat e rrymave të l.sh dhe
9. Analizat e besueshmërisë së SEE

Duke u nisur nga gjendja ekzistuese si dhe propozimeve arkitektonike, SEE distributiv dhe Sistemi Telekomunikues (SK) duhet të bëhet pothuajse tërësisht i ri dhe në përputhje me dy rekomandime të dhëna në vazhdim:

REKOMANDIMET E MASTER PLANIT PER ZHVILLIMIN E SISTEMIT DISTRIBUTIV TË KOSOVËS DERI MË VITIN 2015, QË PËRFSHINË:

Eliminimin gradual të TS 35/10kV dhe kalimin në TS 110/20kV

Kalimin nga rrjeti distributiv 10kV në rrjetin distributiv 20kV

Zëvendësimin e TS 10/0.4kV me ata 20/0.4kV

Zëvendësimin i Linjave Ajrore 230/400V me kablo bistek apo edhe kablo nëntokësorë.

REGULLORET E IEC, IEEE DHE ANSI QË PËR PROJEKTE TË REJA NE VENDE URBANE, LINJAT E FURNIZIMIT ME ENERGI ELEKTRIKE DHE ATO TË RRJETIT TELEKOMUNIKUES TË NDJEKIN TË NJEJTËN TRASË DHE TË REALIZOHEN NË TË NJËJTËN KOHË.

Rekomandimet dhe rregulloret e lartëshënuara obligojnë që SEE dhe SK të realizohen ashtu që:

A. Në njëren anë të trotuarit, të rezervuar për këtë qëllim në thellësi mbi 80cm ndërtohet i ashtuquajtur "kanalizimi kablovik" – fig.1. Në të vendosen gypa PVC me diameter prej 150mm, që përforcohem me beton të klasës C12/15. Kanalizimi kablovik mund të realizohet edhe me gypa të brinjëzuar të futur në rërë. Në këta gypa vendosen:

1. Linja e tensionit 10(20)kV me kablo XHP 49A 240mm². Me këtë bëhet furnizimi i trafostacioneve të blinduara me herës 10(20)/0.4kV dhe fuqi 630kVA, 1000kVA dhe 2x1000kVA.




Fig. 24 Prerja terthore e tubacionit kabllorik

2. Linja e tensionit 400/231V me kablo PP00-A 4x95mm².
3. Linja e tensionit 400/231V me kablo PP00 4x25mm² ose 4x16mm² për furnizime të ndriçimit publik dhe banimeve individuale.
4. Linja e kablllove të komunikimit (kablo me fije optike).
5. Linja e kablllove UTP 4x0.75mm².

B. Përgjat trasës së kanalizimit kabllorik duhet ndërtuar puseta në dimensione dhe forma të ndryshme sipas rastit.

Në trasa të linjave të shumëfishta ndërtohen shahta të kombinuara – rrymë dhe komunikim sipas fig.24. Këto shahta kanë thellsi së paku 1.8m dhe dimensione të brendëshme së paku 1.8mx1.2m. Shahta e përbashkët është e ndarë me murë betoni 20cm në atë për rrymë dhe në atë për komunikim dhe kanë hyrje (vrime) të ndara.

Shaktat për kryqëzime të linjave të tensionit të ulët dhe linjave komunikuese mund të ndërtohen si të ndara dhe mund të kenë edhe dimensione më të vogla (por jo më të vogla se 1.2x1.2x1.2m)





Fig. 25 Prerja terthore

Hyrja në shahta bëhet nëpër vrimën me formë katrore me dimensione së paku 60cm. Në kapak duhet shkruar për puseta rryme – ELEKTRIKA, ndërsa për ato të komunikimit – TELEKOM

Numri i TS-ve është caktuar i fillë që çdo m² i objekteve të ndërtuara në që të tri zonat e ndërtimit do të ketë në disponim fuqinë elektrike të njëkohëshme në vlerë prej:



1. Zona Komeriale	20 W/m ²
2. Zona e Banimit	30 W/m ²
2. Zona Industriale	20W/m ²

Bazuar në kërkesat e lartëshenuara, objekteve që do të ndërtohen në lagjen "Zona Ekonomike" në Prishtinë do të duhet t'i sigurohet energji prej gjithsej rreth 104MVA. Fuqia e Trafostacionit 110/20kV do të jetë 2x63 MVA dhe do të duhej të ndërtohet në qendër të Zonës Ekonomike.

Fuqitë e instaluara dhe lokacionet e trafostacioneve 20/0.4kV janë dhënë në Situacion. Gjithsej janë projektuar 94 Trafostacione Lokale, prej tyre 32 janë me fuqi 630kVA, 40 me fuqi 1000kVA dhe 22 me fuqi 2x1000kVA.

Trafostacionet 20/0.4kV; do të furnizohen me kablo XHP 49A 3x1x240mm², që do të vendosen në kanalizim kablovik. Furnizimi i TS do të bëhet në sistemin unazorë ashtu që të funksionoj sistemi N-1.

Furnizimi i konsumatorëve në nivelin e tensionit të ulët do të bëhet me kablo PP00-A 4x95mm² në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga TS20/0.4 që do të kenë nga 8 dalje të tensionit të ulët.

Pothuajse nëpër qendër të Zonës ekonomike kalojnë shumë linja ekzistuese transmetuese të rëndësishme të tensionit 110kV. Linjat e nivelit 110kV janë me gjësi prej 8m. Sipas rregullave EN 50341-3-1 ndërtimi i objekteve në afërsi të linjave transmetuese është i ndaluar. Distanca e lejuar është 2.0m nga linja 110kV. Në Situacion janë dhënë pozitat e këtyre linjave, si dhe hapësira ku është i ndaluar ndërtimi. Në përgjithsi në këtë lagje ka rreth 10km LP 110kV, Këta LP kanë mundësi të zëvendësohen me linja kablovike nënëtokësore, mirëpo çmimi i një zëvendësimi të tillë do të ishte shumë i lart.

Ndriçimi publik i rrugëve do të bëhet me llampa natriumi me fuqi 250Ë të vendosura në shtylla metalike me lartësi (8-10)m. Kyçja dhe shkyçja e llampave do të jetë automatike, ndërsa në kohën kur rrugët nuk janë shumë të frekuentuara (pas mesnate) llampat më mënyrë automatike do të ndezen në gjysmën e fuqisë nominale.

Linja - rrjeti telekomunikuese do të shpërndahet gjithashtu prej pikave shpërndarëse që do të montohen nëpër të njëjtin kanalizim kablovik, brezit të gjelbërt të trotuareve, nëpër puseta të kombinuara. i tërë rrjeti i telekomunikacionit do të realizohet me kablo optike.



3.6.4 SISTEMI I NGROHJES

Zhvillimi dhe ndërtimi i objekteve të banimit, lokaleve afariste, shkollave e objekteve tjera që do të mbizotërojnë në vitet e ardhshme dhe do të rezultojë me rritje të vazhdueshme të kërkesave për konsum termik e që do të paraqesin edhe bazën për planifikimin, projektimin dhe zhvillimin e një furnizimi qendror me energji termike.

Prandaj përmbushjen e kërkesave me energji termike për objekte banimi, lokale afariste edhe për nevojat tjera, duhet të realizohet në mënyrë kontinue, të sigurtë dhe me një kosto ekonomike.

Konsumatorët termik bashkë me rrjetin dhe burimin e energjisë termike përbëjnë sistemin termik. Ky sistem termik patjetër përcillet edhe me pajisjet tjera ndihmëse, siç janë sistemet e rregullimit e që kanë për qëllim për te siguruar punën normale të impianteve dhe rrjetit, për rastet e ndryshme të ngarkesës termike.

Ngrohja në largësi është mënyra e përfitimit të energjisë me anë të së cilës uji ngrohët në një vend qendror dhe përmes rrjetit shpërndarës shpërndahet deri te konsumatori për shfrytëzim.

Ngrohja në largësi përbëhet nga pjesët themelore si vijon:

Ngrohtorja – kaldajat, flakëhedhësit, oxhaku, rezervuari i lëndës djegëse, përgatitësin e ujit sanitar paisjet dhe aparatet tjera matëse dhe rreguluese dhe të gjitha elementet tjera përcjellëse.

Rrjeti gypor për ngrohje në largësi – nga i cili ujin e ngroht apo të tejnxehur e dërgon në objekte të ndryshme.

Nënstacioni – nga i cili ngrohja (nxehtësia) nga rrjeti gypor primar i ngrohjes në largësi i jepet paisjeve të objekteve (këmbyesve të nxehtësisë)

Rrjeti gypor i objekteve (i brendshëm) ose rrjeti sekondar i cili e shpërndan nxehtësinë në secilin trup ngrohës dhe shpenzus tjerë.

Për instalimin e ngrohjes qendrore në largësi është me rëndësi të shqyrtohet ekonomikiteti për secilin rast në mënyrë të veçant.

Kujdes të veçant për zgjedhjen e këtij sistemi meritojnë faktorët në vijim :

Dendësia e ngarkesës termike për rrethinën që do të ngrohet

Dendësia për sipërfaqe – MW/ km² dhe dendësia për gjatësi MW/km

Shpenzimet për furnizim me nxehtësi

Struktura e rajonit që duhet të ngrohet

Mundësia për paisje të ngrohtorës

Intenziteti i transportit të lëndës djegëse dhe hirit

Lirimi i materijeve të rrezikshme si SO₂ ,pluhuri ,hiri etj.

Vlerat e lejuara të emetimit të ndotësve

Ngarkesa ndaj zhurmës apo intensiteti i zhurmës

Zgjedhja e paramtrave në sistemin e ngrohjes në largësi :

Temperatura e mediumit punues në gypin e furnizimit dhe kthimit

Presioni dhe temperatura e avullit (shfrytëzimi i nxehtësisë)


Veprimi i ngarkesave

Shfrytëzimi vjetor në orë

Koncepti i rrjetit gypor dhe shtrirja e rrjetit :

Me kanal, pa kanal , afat shërbimi (vetitë e tokës)

Përfitimi i sigurt



Rrjeti gypor adekuat
Ujrat nëntoksor dhe sipërfaqësor dhe ujrat buz lumnjeve dhe detit
Lloji i tokës
Përparësitë e ngrohjes në largësi

Nuk ka transportim të lëndës djegëse dhe hirit për në objekt .
Mundësia e shfrytëzimit të lëndës djegëse të lirë si psh. mbeturinat dhe qymyri i hudhur.

Ekonomizimi i madh në shfrytëzimin e lëndës djegëse
Siguria më e madhe e përdorimit , kapaciteti më i madh i kaldajave, punë të panderprerë me më shumë kaldaja .

Kursimi i hapsirës , nuk ka kaldatore , as vend për lënd djegëse as për oxhak në objektet që ngrohen.

Mirëmbajtje e lehtësuar, siguri e madhe kundër zjarrit

Më pak ndotje të ambientit nga SO₂ dhe tymit

Zvoglimit të lirit të CO₂ etj.

Ndarja e sistemeve të ngrohjes në largësi :

Sipas bartësit të nxehtësisë (mediumit punes) ndahen në:

Ngrohja me ujë të ngrohtë me temperaturë deri në 110°C

Ngrohja me ujë të ngrohtë me temperaturë mbi 110°C

Ngrohja me avull

Përparësitë e ngrohjes në largësi me ujë të tejnxehur:

Nuk ka kondenzat e me këtë ska humbje përkatëse

Përdorimi i gypave të lirë nga materiali sintetik

Rrjeti gypor i thjeshtë

Gjatë ndryshimit të madh të temperaturës bëhet edhe transportimi i madh i nxehtësisë në rrjet.

Zvoglimi i humbjeve të nxehtësisë gjatë transportit të nxehtësisë në rrjetë

Thjeshtësimi i mirëmbajtjes


Afatshërbim i gjatë i përdorimit

Ngrohja në largësi me ujë të tejnxehur ka përdorim të gjerë sidomos në ngrohjen e qyteteve tek të cilët përveq ngrohjes qendrore të zakonshme bëhet edhe furnizimi me ujë sanitar (psh. Spitale, fabrika etj.)

Në funksion të temperaturës së jashtme (prej -17°C deri -12°C), bëhet përzierja e ujit të tejnxehur në hyrje (140°C deri 52°C), temperatura projektuese, dhe në dalje (prej 80°C deri 36°C) nga rrjeta e qytetit.

Gjatë temperaturës minimale -17°C, temperatura e ujit të tejnxehur është 130°C, temperatura projektuese, ndërsa në dalje 80°C.

Rrjetet termike, duhet t'i përgjigjen kërkesave të konsumatorëve në sasi dhe cilësi, dmth. bartësi i nxehtësisë kur të arrijë tek konsumatori duhet të ketë parametrat dhe sasinë e kërkuar.



PROPOZIM -ZGJIDHJE

Pas konsultimeve që kemi pasur me drejtorin e TERMOKOS-it na është bërë e ditur se sistemi i KOGJENERIMIT është i parapar vetëm për plotësimin e kapaciteteve egzistuese të TERMOKOS-it. Po ashtu duke pasur parasysh sasinë e madhe të sasisë së nxehtësisë së nevojshme për ngrohje ku sipas llogaritjeve preliminare arrin $Q_n = 361.1$ MW që është disa herë më e madhe se kapaciteti i Termokosit, kjo zonë nuk mund të kyqet në rrjetin e tij. Kapaciteti i ngrohjes i llogaritur për Zonën Ekonomike është si më poshtë:

Zona Industriale	164.53 MW
Zona Komercale	232.42 MW
Zona Komercale Mikse	17.877 MW
Zona M ikse	46.95 MW
Zona e Banimit Kolektiv	29.05 MW
Zona e Banimit Individual	7.98 MW
GJITHËSEJ	508.82 MW

Propozojmë që "Zona Ekonomike" të furnizohet me energji të nxehtësisë nga një ngrohtore e re e cila mund të ndërtohet në pjesën industriale të Zonës Ekonomike. Për zgjedhjen e lokacionit për ndërtimin e ngrohtores duhet pasur parasysh:

-Nga aspekti ekonomik ngrohtorja duhet të vendoset mundësisht sa më afër shrytzesve të saj (dimensionet e rrjetit gypor sa ma të vegjël).

-Furnizimi me lëndë djegëse sa ma i lehtë,

-Të ket mundësi për largimin e hirit

-Furnizimi me uj të freskët

- OXHAKU të mos ket pengesa që do ta pengonin shkujin e nevojshëm të tij

Për shpërndarjen e një sasie kaq të madhe të nxehtësisë duhet zgjedhur kaldaja për prodhimin e ujit të tejnxehur me temperatur $T \geq 110$ °C dhe me ndryshim temperaturash $\Delta t \geq 40$ °C në mënyrë që të kemi një rrjet gypor me dimensione më të vogëla dhe më pak të kushtueshëm.

Për shkak të kursimit perdoren gypat e paraizoluar, pa patur nevojë për punimin e kanaleve të betonit, pra gypat e paraizoluar vendosen në toke dhe si të fillë u rezistojnë kushteve të vështira, posaçërisht në pikepamje të paraqitjes së rrezikut nga korozioni. Kështu që para se të zgjedhen gypat, duhet patur parasysh që ti plotësojë kushtet e fortësisë, izolimit, mbrojtjes nga lagështia, korozioni, etj.

Shpërndarja e rrjetit gypor bëhet në formën e hapur pasi kjo formë është më e thjeshtë dhe më ekonomike.




Mbeshtjellësi i jashtëm

Teli i bakrit – sinjalizuesi

Termoizolimi

Gypi i çelikut

Fig. 26 Detaj i gypit



Rrjeti gypor mund të vendoset në qfardo pozite pa marr parasysh ramjet vetëm që duhet që në pikat më të larta të rrjetit gypor të sigurohet çajrosja ndërsa në pikat më të ulëta zbrazja.

Rrjeti gypor i ngrohjes ne largesi nga grohtorja deri te nenstacioni punohet nga gypat e paraizoluar dhe pjeset fazonike i cili duhet ti pergjigjet standardeve si vijon :

- Gypat e paraizoluar EN253
- Pjeset fazonike te paraizoluar EN 448
- Armaturat e paraizoluara EN 488
- Lidheset e gypave te paraizoluara EN 489

Gypat duhet te ken te montuar telat e bakrit perqes- sensorik per kontrollimin e prezences se lageshtis .

Gjat montimit perqesit duhet te lidhen ne menyre te rregullt , duke e vertetuar e rrethit perqes si dhe duke e matur vleren fillestare te rezistences e cila eshte e dhene (vler referente)per kontrolla te me vonshme te lagshtis.

Këta gypa përdorën për të transportuar mediumin punues (ujin ose avullin e ujit)prej ngrohtores gjer te shpenzuesi.


Gypat e paraizoluar duhet të jenë të punuar nga shkuma e poliuretanit, e cila është e futur me presion në mes të gypit të çelikut dhe shtresës mbrojtëse të plastikës në pjesën e jashtme. Këta gypa duhet të kenë atestet e kualitetit të materialit dhe të jenë të punuar sipas standardeve, pra t'i plotesojne normat dhe standardet teknike te bashkësisë europiane.

Pozita e gypave duhet të jetë në kuotën $H=-1.00$ m, çka përfundi rrugës nuk paraqitet rrezik nga shembja e dheut dhe vibracionet e mundshme nga komunikacioni rrugor, sepse janë marrë parasysh ngarkesat e tokës dhe të gypave percjellëse pergjate rrugës.

Rrjeti gypor vendoset në kanal in e hapur në formë trapezi ku së pari shtrohet një shtresë me trashsi 100-150 mm me rërë të imët mbi të cilën vendosen gypat dhe mbulohen po ashtu me rërë të imët 100-150 mm mbi gypat e paraizoluar. Mbi rërën e imët vendoset dheu pa përmbajtje të gurëve të mprehtë. Distanca mes gypave është sa diametri i njërit gyp.



Fig. 27 Pozita e rrjetit gypor në kanal



Mbi shtresën e dheut vendoset një shirit sinjalizues i cili duhet të jetë 400 mm nën sipërfaqen e tokës i cili shërben si paralajmërim gjatë gjurmimeve se gypat gjenden nën të.

Degëzimi i rrjetit gypor bëhet me ndihmën e elementeve të paraizoluara si kthesa 90°, 45°, T-pjesë, T-pjesë, reduktues, vazhduese, tupa etj.

Në shtresën e termoizolimit janë të vendosur telat sinjalizues të cilët në rast rrjedhjeje e aktivizojnë alarmin në ngrohtore.

Pusetat sipas funksionit parashihen për :

Organe për mbyllje dhe pajisjet matëse

Ç'ajrosje dhe zbrastje


Kompenzatorë

Hyrje në nënstacione termike të objekteve

Kontroll të rrjetit

Ndërprerjen e ujit në raste të havarive të paraqitura

Pusetat duhet të ekzekutohen sipas standardeve dhe normativave në atë mënyrë që gjatë intervenimeve të mundshme, ekipa e mirëmbajtjes së magjistratit të ujit të ngrohtë pa pengesa të kryej punimet e mirëmbajtjes, apo zëvendësimet e armaturave të ndryshme. Pra pusetat në parim duhet të jenë të ekzekutuara si të kalueshme për armaturën dhe personelin. Për shkak të kushteve ekonomike dhe sigurisë së vetë sistemit magjistrat, duhet të aplikohen sa më pak pusetat dhe ato të lidhen si shumë funksionale në degëzimet dhe furnizimin e pjesëve të qytetit.



3.7 PLANI I PARCELIMIT DHE RIPARCELIMIT

Plani i parcelimit ekzistues është i prezentuar në hartën 3 Plani kadastral.
Plani i riparcelimit prezentohet në hartën 9 – Plani i riparcelimit.

Rastet e riparcelimit janë

- Riparcelimi i blloqeve industriale, dhe ekonomike bëhet në nënbloqe më të vogla dhe duhet të ketë fleksibilitet që në të ardhmen varësiht nga nevoja të ketë mundësi ndryshimi. Varianti i dhënë në pjesën grafike është një propozim i mundshëm.
- Riparcelimi i blloqeve Mikse në parcelat pjesërisht të ndërtuara – bëhet për të hapur rrugët e planifikuara. Rrugët ekzistuese kyçen në rrugë të reja brenda lagjes. Ndarja në nënbloqe është bërë për të lehtësuar implementimin. Edhe në këto blloqe duhet të kemi fleksibilitet në riparcelim varësisht nga kërkesa e banorëve. Varianti i dhënë në pjesën grafike është një propozim i mundshëm.

Varësisht prej shkallës së ndërtimit ekzistues dhe tipit të planifikuar të ndërtimit të ri:

- Blloqet e lira – riparcelohen menjëherë dhe ndërtimi i ri bëhet brenda parcelave të reja urbane.
- Blloqet e ndërtuara mbesin të tilla derisa të ketë kërkesa për zhvillim dhe ndërtime të reja me mundësi të rigjenerimit ose **ridestinimit** (në rastet e blloqeve industriale ose atyre ekonomike) të bllokut përmes futjes së rrugëve të reja me ç'rast bëhet edhe riparcelimi i bllokut. Objektet që rrënohen për të mundësuar ndërhyrjet duhet të kompenzohen. Banorëve duhet ofruar strehim.

Realizimi i planit bëhet në faza varësisht nga interesi i banorëve dhe investitorëve. Të gjitha intervenimet dhe ndryshimet realizohen në marrëveshje paraprake me banorët.



3.8 NORMAT DHE STANDARDET TEKNIKE PËR ZHVILLIMIN URBAN DUKE PËRFSHIRË SHKALLËN E PLANEVE

Gjatë llogaritjes së koeficientave janë përdorur normativat siç vijojnë:

Nr. mesatar i punëtorëve për hektarë	150 punëtorë/ha
Madhësia minimale e parcelës industriale	2.0 ha
Madhësia minimale e parcelës komerciale	1.0 ha
Madhësia minimale e parcelës së banimit individual	300 m ²
Sipërfaqja minimale për banim për person (brutto)	25.0 m ²
Sipërfaqja minimale për banim për person (netto)	18.0 m ²
Sipërfaqja mesatare për 1 apartament	80.0 m ²
Nr. mesatar i ban. për 1 apartman	5.0 banorë
Nr. mesatar i ban. për 1 shtëpi	6.0 banorë
Nr. i femijeve parashkollorë për 1000 banorë	70.0 femijë
Sip. e afarizmit për 1 garazhim/vendparkim	30.0 m ²
Sasi e mbeturinave kg/banore, ditë	1.6 kg

Tab. 6 Normativat për llogaritje:

3.8.1 BILANSI I SIPËRFAQEVE SIPAS PRRU ZONA EKONOMIKE

Sipas PRRU "Zona Ekonomike" koeficientat mesatar të lagjes do jenë:


ISHP= 0.4, ndersa ISD=1.20

Sip. Neto e lagjes:		5,365,953.00	m ²		
Sip. Bruto e lagjes:		6,119,709.00	m ²		
PERMBAJTJA		<i>Gjendja e Ekzistuese</i>		<i>Gjendja e Propozuar</i>	
		<i>Sip. (m²)</i>	<i>Koeficienti mesatar i shfrytezimit</i>	<i>Sip(m²)</i>	<i>Koeficienti mesatar i shfrytezimit</i>
1	Sip. tot. e ndërtimit në Përdhesë (m ²)	50,842.97	0.02	1,759.930	0.4
2	Sip. tot. e ndërtimit nëpër Kate (m ²)	357,126.96	0.03	5,818.737	1.2

Tab. 7 Sipërfaqet e ndërtuara:

përmbajtja		sipërfaqja	përqindja
		<i>(m²)</i>	<i>(%)</i>
1	Rrugë, trotuare	668,489	11.6%
2	Sip. ndërtimi në Përdhesë	1,759,930	30.7%
3	Sip. Gjellërim	2,410,428	42.0%
4	Sheshe, shtigje, rrugica, tampone gjelberimi etj.	901,915	15.7%
Sip. Bruto e lagjes:		5,740,763	100.0%


Tab. 8 Siperfaqet ekzistuese dhe te propozuara sipas destinimit:




3.9 KUSHTET URB-ARKITEKTONIKE



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo / Republika Kosova
Komuna e Prishtinës
Municipality of Prishtina / Opština Pristina





3.10 KUSHTET DHE KRITERET PËR MBROJTJE MJEDISORE

3.10.1 KUSHTET DHE KRITERET PËR MBROJTJEN E MJEDISIT JETËSOR

Në përgjithësi kushtet dhe kriteret për mbrojtje mjedisore në lagjen "Zona Ekonomike" përcaktohen me ligjet dhe rregulloret relevante në fuqi në Republikën e Kosovës si:

Ligji për ndryshimin e ligjit për planifikimin hapësinor nr. 2003-14 (Ligji nr. 03/L-106)

Ligjin për Planifikim Hapsinor (Ligji nr. 2003/14)

Ligji për mbrojtjen e mjedisit (Ligji nr. 03/L-025)

Ligji për tokat bujqësore (Ligji nr. 02/L-26)

Ligji për ujërat

Ligji për mbeturinat

Ligji për mbrojtjen nga zjarri

Ligji për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera


Ligji për mbrojtje nga zhurma

Në veçanti në lagjen "Zona Ekonomike" kushtet dhe kriteret për mbrojtje mjedisore parashohin:

- Në zonën e lagjes nuk lejohen ato veprimtari që shkaktojnë tym, avull, zhurmë, kundërmim ose pluhur deri në atë masë që të jenë të rrezikshëm, sulmues dhe dëmtoese për shëndet;
- Përgjatë rrugëve përmbledhëse dhe rrugëve lokale duhet të sigurohet korridor gjelbërimi me qëllim të izolimit nga ndotja;
- Të hartohen strategji dhe planet emergjente për mbrojtje të mjedisit kundër – termetit, zjarreve, vërshimeve, erozionit, ndotjes së ajrit dhe të tjera;
- Strategjitë për menaxhimin e mbeturinave duhet të kontrollohen nga komuna në mënyrë të vazhdueshme për ti mënjeluar ndikimet mjedisore;
- Koncepti komunal për mbrojtje mjedisore duhet të hartohet – rregulloret shtesë në nivelin komunal që plotësojnë kornizën ligjore mjedisore nga niveli qendror dhe bëjnë më të lehtë zbatimin e tij. (shih: konventa mjedisore lokale – hartuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës).

3.10.2 KUSHTET PËR LËVIZJE TË LIRË PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Në lagjen "Zona Ekonomike" në pronën publike dhe objektet e shfrytëzimit publik duhet të sigurohet qasje dhe lëvizje e lirë për personat me aftësi të kufizuara konform ligjeve dhe rregulloreve në fuqi si dhe standardeve ndërkombëtare në këtë fushë.



3.11 KUSHTET DHE KRITERET PËR SHFRYTËZIM RACIONAL TË ENERGJISË

Kushtet e përgjithshme për shfrytëzim racional të energjisë përcaktohen në Ligjin për efikasitetin e energjisë (04/L-016).

Kushtet e veqanta për shfrytëzim racional të energjisë kanë të bëjnë me:

Kushtet për përmirësimin e efikasitetit të energjisë elektrike –Poashtu

Kushtet për kursimin e energjisë elektrike -

Për të gjitha objektet ekzistuese duhet të mirren masa për rritjen e izolimit termik të tyre me qëllim të kursimit dhe shfrytëzimit racional të energjisë.

Të gjitha propozimet për ndërtim të objekteve të reja duhet të prezantojnë skemat për shfrytëzim racional të energjisë dhe duhet të përmbajnë kushtet për kursimin e energjisë.

Skemat e shfrytëzimit të energjisë alternative duhet të subvencionohen me anë të **planit ekonomik të Zonës Ekonomike**.

Banorët e lagjes duhet të inkurajohen për shfrytëzim racional të energjisë përmes programeve komunal dhe më gjerë për përmirësimin e efikasitetit të energjisë.

3.12 KUSHTET URBANE PËR SIPËRFAQET PUBLIKE, PRIVATE SI DHE ELEMENTET PËRCJELLËSE

3.12.1 SIPËRFAQJA E LIRË PUBLIKE

Sipërfaqja e lire publike është sipërfaqja jo e ndërtuar brenda një zone të caktuar urbane shfrytëzimi i së cilës është kryesisht i dedikuar për sheshe, parqe, shirita dhe koridore të gjelbra, sport dhe rekreacion, etj. Këtu po ashtu bëjnë pjesë edhe sipërfaqet ujore. Në shumicën e hapësirave ndërtimi nuk është i lejuar, përveç ndërtimeve të cilat mbështesin aktivitetet që mund të jenë pjesë e sipërfaqeve të gjelbëra.

Në lokacionin e definuar me PRrU është paraparë shtimi i hapësirave të lira publike. Në këtë zonë janë paraparë disa koridore gjelbërimi përgjatë rrugëve primare dhe përgjatë lumit, terrene sportive në kuadër të kompleksit të shkollave të mesme.

Sipërfaqja e lirë publike e klasifikuar me sipërfaqe të gjelbërta / parqe, sport dhe rekreim, shirita gjelbërimi dhe lum do të përfshijë një sipërfaqe prej 146.31 ha e cila krahasuar me sipërfaqen e lirë publike ekzistuese ka një rritje të dukshme.

Poashtu brenda ngastrave individuale detyrimisht duhet të parashihen sipërfaqe të lira/të pandërtuara si hapësira gjelbërimi rreth 50% e sipërfaqes totale, lojë të fëmijëve, sheshe, etj.

Klasifikimi i sipërfaqeve të lira / të pandërtuara është e ndarë në:

1. Hapësirë e gjelbër
2. Sport dhe rekreim
3. Shirit gjelbërimi
4. Sipërfaqe ujore
5. Gjelbërimi në kuadër të ngastrës




1. Hapësirat e gjelbërta apo parqet e pushimit përfshinë përmbajtje të lojës për fëmijë, shtigje të këmbësorëve, hapësira për piknik dhe rekreim. Kjo hapësirë shtrihet në pjesën VP përgjatë të lumit Prishtevka.
2. Sporti dhe rekreimi në kuadër të hapësirave të lira-parashihen në hapësirën e propozuar për sport dhe rekreim që ndodhet afër xhamisë ekzistuese. Hapësirat për sport dhe rekreim si loja për fëmijë, fusha për sport duhet të parashihen edhe brenda blloqeve të banimit varësisht prej kërkesës së banorëve.
3. Shiritët e gjelbërimit janë hapësira të gjelbërimit të parapara si barriera mbrojtës ndaj zonave të caktuara dhe rrugëve. Shiriti i gjelbërimit $d=10m$ përgjatë hekurudhës përveç mbrojtjes nga zhurma dhe ndotja në të njëjtën kohë përmirëson pamjen vizuale të rrugës dhe hapësirës përreth. Sipërfaqet e gjelbra në profilet e rrugës duhet të jetë rezistent ndaj nivelit të lartë të ndotjes. Duhet kontrolluar lartësinë dhe kurorën e tyre në mënyrë që të mos pengohet trafiku. Drunjtë e rrugëve duhet të:
 - sigurojnë definimin e profilit;
 - të jenë rezistent ndaj ndotjes dhe pluhurit (me gjethe të mëdha, kurorë të madhe);
 - të mos pengojnë shikueshmërinë.
4. Në zonën e përcaktuar me PRRU ka sipërfaqe ujore-lumi "Prishtevka" që e ndanë lagjen në gjatësi por pjesërisht është i mbuluar dhe shërben edhe si kanalizues i ujërave të zeza dhe hapësira mbi të shfrytëzohet për rrugë të automjeteve. Duke marr parasysh rëndësinë e sipërfaqeve ujore në kuadër të sipërfaqeve të gjelbëra dhe vet zonës është planifikuar që ky lum të gjallërohet dhe të potencohet me disa segmente të propozuara. Këto segmente të ujit të përcjellur me gjelbërim mund të jetë oazë pushimi për banorët e zonës poashtu edhe të shëndrohet në vend atraktiv për qytetar.
5. Gjelbërimi në kuadër të ngastrës është i detyruar dhe duhet të parashihet nga secili zhvillues i ngastrës. Raporti i sipërfaqes së ndërtuar përcaktohet varësisht prej etazhitetit, hapësira e gjelbër duhet të përfshijë min 50% të sipërfaqes së përgjithshme. Gjelbërimi i lartë në kuadër të ngastrës duhet të vendoset në mënyrë proporcionale përgjatë qarkullimit të trafikut, oborrit, në hapësirat e parkingjeve dhe në qasjet e parcelës. Pasi që këto hapësira nuk janë publike ato mund të organizohen në kuadër të ngastrave individuale varësisht prej kërkesës së investitorit.

Raporti i hapësirave të pllakëzuara dhe atyre të gjelbërta duhet minimum të jetë 80%:20% në të mirë të sipërfaqeve të gjelbruara në të cilën duhet të jenë rekuizitat për rekreim. Kjo sipërfaqe duhet të jetë e mbrojtur me shirit të gjelbërim të lartë (për mbrojtje nga zhurma dhe ndotja). Në pjesën grafike nuk janë paraqitur hapësirat e tilla.

Kushtet e rregullimit të sipërfaqeve të lira janë:


- Trajtimi i gjelbërimit përgjatë rrugëve;
- Përqindja e sipërfaqeve të gjelbëra në ngastër;
- Zonat e përcaktuara për sipërfaqe të lira (vija rregulative, vija ndërtimore, tampon gjelbërimi, pjesa e pasme, etj)



3.13 KËRKESAT E VEÇANTA, KUSHTET DHE RREGULLORET E DOMOSDOSHME PËR LËSHIMIN E LEJES NDËRTIMORE

Leja ndërtimore

- Të interesuarit për ndërtim në lagje duhet të aplikojnë për Leje ndërtimore sipas rregulloreve dhe procedurave të parapara në Komunën e Prishtinës dhe konform Ligjit për ndërtim, Ligjit për Planifikim Hapësinor, dhe ligjeve tjera relevante në Republikën e Kosovës.
- Procesi i ofrimit të lejes apo refuzimit të kërkesë për leje, përfshinë garancinë për rolet transparente të të gjitha palëve me interes (pronarët, ndërmarrjet, palët tjera me interes dhe administrata) do të përmirësohen përmes qartësimit të procedurave;
- Një bazë adekuate për riparcelizim duhet ta asistojnë procesin e lëshimit të lejeve. Ky aktivitet duhet realizuar në bashkëpunim me drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër;
- Leja ndërtimore mund të lëshohet vetëm pas aprovimit të PRrU të lagjes "Zona Ekonomike";
- Leja ndërtimore mund të lëshohet vetëm pasi të plotësohen kushtet për vendosjen e veprimtarive të caktuara.



3.14 VLERAT ME RËNDËSI NATYRORE, KULTURORE, HISTORIKE SI DHE OBJEKTET PËR TË CILAT ËSHTË E DOMOSDOSHME TË SIGUROHET MBROJTJE

3.14.1 VLERAT ME RËNDËSI NATYRORE, KULTURORE, HISTORIKE

Gjatë hartimit të Profilit Urban dhe nga shenimet e marra nuk janë evidentuar vlera me rëndësi natyrore, kulturore apo historike në lagjen Zona Ekonomike.

3.14.2 OBJEKTET NË MBROJTJE

Sipas deklaratës nga Instituti i Monumenteve dhe Muzeu Rajonal i Prishtinës nga Janri i v.2010 kemi dy objekte në mbrojtje që janë në afërsi të zonës: Monumenti i Gazimestanit dhe Tyrbja e Bajraktareve.

452190
 9.01.2010

INSTITUTI I MONUMENTEVE
 DHE MUZEU RAJONAL -
 PRISHTINE



INSTITUTE FOR MONUMENTS
 AND REGIONAL MUSEUM OF
 PRISHTINA

19. 01. 2010
 Prishtinë

Për: Hidroing – DK Prishtinë

Nga: Instituti i Monumenteve dhe Muzeu Rajonal i Prishtinës

Lënda: Përgjigje kërkesës për informata mbiobjektet eventuale të mbrojtura në
 Lagjen “Medrese – Camëria” Prishtinë

Ju informojmë se në lagjen “Medrese – Camëria nuk ka objekte të mbrojtura nga IMMRP, mirëpo kjo lagje ka potencial për gjetje arkeologjike. Ndërsa, në “Zonën Ekonomike” gjendet Monumenti i Gazimestanit dhe Tyrbja e Bajraktarëve që përfshin sipërfaqe prej 100 hektarësh. Poashtu kjo zonë është potenciale për gjetje arkeologjike.

Komisioni :

Valbona Saliuka, Ark

Lindita Cërvadiku Dibra, Ark


Miftar Miftari, Historian



Drejtori i IMMRP:

Hagji Mehmetaj

Fig. 28 Informata nga IMMR Prishtinë



3.15 KUSHTET NË LIDHJE ME MBROJTJEN MJEDISORE NGA LLOJE TË NDRYSHME TË NDOTJES, MBROJTJA E BIODIVERSITETIT, MBROJTJA NGA ZJARRI DHE FATKEQËSITË E TJERA, SI DHE SHKATËRRIMET

3.15.1 KUSHTET PËR MBROJTJE NGA LLOJE TË NDRYSHME TË NDOTJES

Kushtet e përgjithshme për mbrojtje nga lloje të ndryshme të ndotjes përcaktohen me ligjet në fuqi:

- Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja (03/L-160)
- Ligji për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes (03/L-043)
- Ligji për mbrojtjen e bimëve (02/L-95)
- Ligji për mbrojtjen nga zhurma (02/L-102)
- Ligji për mbrojtjen e mjedisit (03/L-025)
- Ligji për mbrojtjen e natyrës (03/L-233)
- Ligji për Mbrojtje nga Rrezatimi Jojonizues, Jonizues dhe Sigurinë Nukleare (03/L-104)

Konform këtyre ligjeve dhe në përgjithësi konform standardeve të krijimit të një mjedisi të shëndoshë, me këtë plan ndalohen të gjitha veprimtaritë që shkaktojnë ndotje të ambientit, përfshi këtu, tokës, ajrit, ujit, shkaktojnë zhurmë apo rrezatim të dëmshëm për shëndetin e njeriut dhe gjallesat në tokë, respektivisht lagjen e përfshirë me këtë plan rregullues.

3.15.2 KUSHTET PËR MBROJTJE NGA ZJARRI, FATKEQËSIVE NATYRORE DHE FATKEQËSIVE TJERA


Kushtet e përgjithshme për mbrojtje nga zjarri, fatkeqësite elementare dhe shkatërrimet me ndikim në rregullimin dhe ndërtimin e hapësirës së përfshirë me këtë plan nënkuptojnë përmbajtjen e:

- Ligjit për mbrojtje nga zjarri

[Ligji për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera](#)

- Rregullave për vendosjen e hidrantëve dhe pajisjeve tjera për shuarjen e zjarrit
- Rregullave për instalimet elektrike
- Rregullave për mbrojtjen e ndërtesës ndaj shkarkimeve atmosferike
- Rregullave për ndërtimin e objekteve konform kushteve seizmike

Konform këtyre ligjeve dhe në përgjithësi konform rregullave dhe standardeve të ndërtimit të mbrojtur nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, me këtë plan ndalohen të gjitha veprimtaritë që rrezikojnë sigurinë e objekteve dhe banorëve të lagjes. Poashtu të gjitha ndërtimet në lagje duhet t'i përmbushin kriteret e sigurisë konform ligjeve dhe rregulloreve të lartpërmendura.



3.16 LLOJI DHE KARAKTERI I OBJEKTIT QË MUND TË NDËRTOHET NËN KUSHTET E PËRCAKTUARA ME PLAN OSE NËN KUSHTE TË VEÇANTA

3.16.1 KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR VENDOSJE TË NDËRTESAVE TË PËRKOQSHME

- destinimi i ndërtesave të tilla duhet të jetë jo industri;
- nuk guxon të ketë më shumë se 60 m²;
- ndërtesat e përkohshme duhet të kenë strukturë të lehtë, nuk mund të jenë të muratuara nga tullat, betoni ose elemente tjera të forta ndërtimore;
- ndërtesat duhet të jenë montazhe (për të plotësuar kriterin e largimit për 24 orë);
- në një parcelle ndërtimore mund të vendosen disa objekte të përkohshme.

3.16.2 KUSHTET PËR VENDOSJEN E NDËRTESAVE

3.16.2.1 Kushte të përgjithshme

- të gjitha ndërtesat e reja duhet ti përmbahen kushteve të lokacionit si: vijës rregulluese, vija ndërtimore, etazhiteti, raporti i sipërfaqes së ndërtuar dhe sipërfaqes së lirë, distanca në mes të ndërtesave, parkimit, gjelbërimit, etj;
- formësimi i strukturës fizike duke respektuar formën perimetrike të blloqeve urbane;
- ndërtesat duhet të projektohen ashtu që t'i përshtaten karakterit dhe kontekstit të rrethinës;
- ndërtesat duhet të jenë fleksibile me qëllim të modifikimit dhe rishfrytëzimit të strukturës ekzistuese;
- praktikat e dizajnit të ndërtesave të gjelbëra (ruajtja e energjisë dhe reduktimi i ndikimit në mjedis);
- ndërtesat e funksioneve të ndryshme dallojnë për nga pjesa ballore e ndërtesës, madhësia dhe forma e ngastrës, volume i ndërtesës, kualiteti i dizajnit, lidhja me funksionet përreth, nevojat e parkimit, hapësira për qarkullim të komunikacionit, dhe peizazhi natyror;
- çdo ndërtesë duhet të ketë vend parkim të duhur;
- çdo ndërtesë duhet të ketë qarkullim efikas.

3.16.2.2 Kushtet për përcaktimin e kotës së përdhësës

Kota e përdhësës së ndërtesës përcaktohet në raport me kotën e niveletës së rrugës publike gjegjësisht në krahasim me kotën zero,

- kota e përdhësës së ndërtesave të reja nuk mund të jetë më e ulët se sa kota e niveletës së rrugës publike;
- kota e përdhësës mund të jetë më së shumti 1.2 m mbi kotën e niveletës së rrugës publike;
- për ndërtesat që në përdhësë kanë tregti apo shërbime, kota e përdhësës mund të jetë më madhe se kota e trotuarit për max. 0.3 m;
- në raste kur nuk mund të zbatohen këto rregulla, kur terreni është i pjerrët apo në raste tjera, kota e përdhësës duhet të përcaktohet përmes lejës urbanistike.

3.16.2.3 Ndërtesat e banimit

Banimi ndahet në banim shumëbanesor dhe banim individual.



- *Banimi shumëbanesor* ka njësitë banimore të ngjitura si në horizontale ashtu edhe në vertikale. Lartësia e tyre shkon prej 3 deri në 4 etazhe me bërthamë të përbashkët (komunikim vertikal të përbashkët). Këto ndërtesa mund të kenë parkim brenda strukturës apo në të hapur.
- *Banimi individual* karakterizohen me një njësi banimore pra shërbejnë vetëm për një familje (6 anëtarë mesatarja) dhe lartësia e tyre shkon prej 2-3 etazhe. Këto ndërtesa mund të kenë parkim brenda strukturës, aneks të strukturës apo në të hapur.

Mundësohet zhvillimi i disa tipeve të ndërtesave shumëbanesore

- Tipi bllok i ndërtesave, formë kompakte e ndërtesës që rezulton me dendësi më të lartë të banimit dhe hapësira e jashtme është më e kufizuar ;
- Tipi linear i ndërtesave, form më e lirë (e hapur) e ndërtesës, ka pak apo nuk ka kufizim të hapësirës së jashtme;
- Banimi shumëbanesor duhet të ketë llojllojshmëri të njërive banimore si banesa njëdhomëshe, dydhomëshe, tridhomëshe dhe banesa katërdhomëshe dhe të planifikohet varësisht prej kërkesave të banorëve. Mirëpo bazuar në mesatarën e anëtarëve të familjes dhe sigurimin e sipërfaqes për banim 18 m² per person sipërfaqja me e kërkuar e banesave do të jetë ~85 m² netto që janë banesat tri deri katër dhomëshe.

Mundësohet zhvillimi i të gjitha tipeve të ndërtesave të banimit individual

- Tipi i veçantë i shtëpisë;
- Tipi i shtëpisë dyshe (dy shtëpi të ngjitura);
- Tipi i shtëpisë në varg (tre a më shumë shtëpi të ngjitura);


3.16.2.4 Ndërtesat afariste (Ndërtesat e punës)

Ndërtesat afariste janë struktura të dedikuara për punë, tregti ose hulumtim dhe kanë këto karakteristika të përbashkëta:

- Baza të kateve të përsëritura
- Hapësira të hapura dhe fleksibile
- Bërthama që përmban liftin, shkallët, sistemet mekanike të ndërtesës dhe elemente tjera të përbashkëta.

Afarizmi ndahet në veprimtari tregtare & zejtare, ndërtesa shërbyese (zyre) dhe në veprimtari hotelierike (restaurante, bare, hotele).

- Veprimtaritë afariste mund të vendosen në një ndërtesë të përbashkët ose në ndërtesë të veçantë.
- Preferohet përzjerja e veprimtarive afariste në një ndërtesë Kushtet e veçanta të hapësirave për zyre
- Orientimi varet nga lokacioni, preferohet aksi lindje—perendim;
- Dimensionet tipike të bazës së planimetrisë janë 45m x 36m dhe 60m x 45m ;
- Ndërtesa sa më fleksibile për organizim me mundësi të lëvizjes së murreve të brendshme;
- Lartësia dysheme-dysheme për zyre është 2.7 m deri 3.6 m;
- Distanca në mes të bërthamës (komunikimi vertikal) dhe skajit të ndërtesës duhet të jetë 25 m;
- Distanca në mes të dy bërthamave duhet të jetë 50 m;
- Sigurimi i ndriqimit dhe ventilimit të mirë;
- Qasje për parkim (parkim nëntokësor) dhe hyrje ekonomike (doku për furnizim);
- 1 parkingj për 30m² të ndërtesës;
- Shenjëzim i kuptueshëm dhe dizajn unik i hyrjes.



3.16.2.5 Kushtet e veçanta të hapësirave për tregti

- Lartësia dysheme-dysheme për tregti është 3.6-5.4m me mundësi të vendosjes së kabllave dhe sistemeve tjera të ndërtesës;
- Qasja e vizitorëve në ballë dhe qasja e kamionëve anash;
- Shfrytëzimi efikas i hapësirës (hapësira në mes të shtyllave 6.4 m e rritë fleksibilitetin)
- Rampat për kamion duhet të jenë max. 5%

3.16.2.6 Ndërtesat e institucioneve publike

Në lokacionin e përcaktuar me PRrU janë planifikuar këto përmbajtje sociale:

- 3 çerdhe/kopësht për fëmijët e banorëve të lagjes në zonën e Banimit dhe atë Mikse.
- Propozohet edhe 1 shkollë fillore që është e nevojshme për banorët e kësaj lagjeje dhe lokacioni mbetet të vendoset nga KK. Prishtinës.

Zhvillimi i mirëfillt i lagjes duhet të shoqërohet me një aplikim adekuat të infrastrukturës sociale për banorët e tanishëm dhe ata që do vinë. Në mungesë të shënimeve të sakta statistikore, për vlerësimin e kërkesave për infrastrukturën sociale skica e llogaritjes është bërë me supozim, vlerat e përgjithshme në nivel shtetëror dhe formula për llogaritje demografike.

Duke u bazuar në këto supozime dhe në sipërfaqen e mundshme të ndërtimit suposohet se në lagjen "Zona Ekonomike" do jetojnë rreth **31 mijë ban.**

Duke llogaritur në bazat e madhësive standarde, numrin e fëmijëve në përkujdesjen e nevojshme edukative rrjedh se fitojmë këto të dhëna:


totali i banoreve			30,922					
Grup mosha e femijeve (1) vjeç	1.50%		463.00					
Seksioni i edukimit të femijeve	vitet	Furnizimi për femije	Numri i femijeve	Sip. për femije (m ²)	Sip. E parcelës (m ²)	Sip. e nevojshme për objekt (m ²)	Femije në objekt	Numri i objekteve të nevojshme
Çerdhe (0-3)	2.5	30%	347	10	3,470	400	60	6
Parashkollore (3-6)	3.5	100%	1,620	25	40,500	2,500	125	13
Edukimi fillor (6-12)	5	100%	2,315	15	34,725	7,500	600	4
Seksioni i ulët (12-15)	4	100%	1,852	15	27,780	7,500	700	3
Seksioni i lartë (15-18)	3	50%	694	15	10,410	5,625	375	2
			6,828		116,885			

Tab. 10 Numri i objekteve edukativo-arsimore

Nga këto koeficienta perfundojmë se nevojiten më shumë objekte parashkollore dhe shkollore. Duke marrë në konsideratë gjendjen aktuale të pronësisë kemi përcaktuar min. 1 objekt shkollor dhe 3 parashkollor që do e mbulojnë nevojën minimale të banorëve dhe rrezembulueshmërinë në aspektin hapësinor.

Sheshet e lojrave dhe paisjet sportive

Në përputhshmëri me standardet gjenerale të planifikimit urban një sipërfaqe prej 1m² e sheshit për lojë për banorë për fëmijët e moshës 3-11 vjeç është e nevojshme. Sheshet e lojrave duhet të jenë pjesë integrale e fqinjësisë në formësimin e blloqeve të vogla të banimit. Sheshet e lojrave do të integrohen çdokund brenda zonës së banimit dhe atë mikse. Sa i përket paisjeve sportive që duhet të jetë 1.5m²/ban. Edhe këto do të organizohen në njësitë e bllokut e disa prej tyre do të



jenë të grupuara në hapësirat e shkollave që të mund të shfrytëzohen edhe nga komuniteti.

Kushtet e veçanta për çerdhe / kopësht:

- Siperfaqja e lokacionit 25m²/fëmijë ose 0.25-0.3ha;
- Hyrja për në ndërtesë duhet të sigurohet nga rruga e brendshme-për qasje;
- Çerdhe (fëmijë 8 muaj-3 vjeç) duhet të jenë grupe prej 6-8 fëmijë me sipërfaqe 2-3m² / fëmijë;
- Kopshti (fëmijë 3 vjeç-6 vjeç) duhet të jenë grupe prej 25-30 fëmijë me sipërfaqe 1.5-3m² / fëmijë;
- Qendra për kujdes të fëmijëve mbas shkollës (fëmijë 6 vjeç—15 vjeç) duhet të jenë grupe prej 25—30 fëmijë me sipërfaqe 1.5-4m² / fëmijë;
- Dhoma për një grupi fëmijësh duhet të jetë min. 60m²;
- në zonat urbane ndërtesa preferohet të jetë me 2 etazhe;
- Minimum 6 vend parkingje dhe hapësirë për biçikleta dhe karroca
- Hapësira minimale për lojë të fëmijëve është 40 m² (5 m² për njësi banimi);
- Hapësira për lojë duhet të jetë e mbyllur / e kufizuar me barierë min. 1 m me qëllim të mbrojtjes nga rruga, veturat e parkuara, uji dhe burimeve tjera të rrezikut.

Tab. 11 Normativa per infrastrukturen sociale


grup mosha	sipërfaqja	distanca nga shtepia	
		(m)	(minuta)
0-6	0.6	110-230	2
6-12	0.5	350-450	5
12-18	0.9	700-1000	15

- Hapësira për lojë varet edhe nga grup mosha, sipërfaqja e shfrytëzuar për person, etj.

3.16.2.7 Hapësira e parkimit

Secila ngastër duhet të ketë parkim të mjaftueshëm për të zhvilluar veprimtarinë e saj;

- Veprimtaritë e banimit duhet të kenë 1 parking për njësi banimore;
- Veprimtaritë e afarizmit duhet të kenë 1 parking për 30 m² të ndërtesës;
- Institucionet shkollore duhet të kenë 2 parkingje për 100m² të ndërtesës;
- Institucionet parashkollore duhet të kenë 1 parking për 20 fëmijë;
- Institucionet shëndetësore duhet të kenë 1 parking për 30 m² neto të ndërtesës;
- Parkingjet e hapura preferohet të vendosen mbrapa ndërtesave;
- Parkimi i mbyllur nën strukturën e ndërtesës mund ta tejkaloj sipërfaqen bruto të bazës (sipërfaqen e shputës);



3.17 LLOJI DHE SHFRYTËZIMI I OBJEKTIT, NDËRTIMI I TË CILIT ËSHTË I NDALUAR NË ZONA TË ÇAKTUARA

Në tërë lagjen "Zona Ekonomike" të përfshirë në këtë plan rregullues ndalohet ndërtimi i çdo lloj objekti që nuk i përmbush kriteret e mbrojtjes së mjedisit (Kapitulli 3.10) dhe mbrojtjes nga ndotja dhe fatkeqësitë (Kapitulli 3.15).

3.18 POZITA E OBJEKTIT NË PARCELË DHE NË KUADËR TË PARCELAVE FQINJE

Objekti realizohet brenda një parcele ose grup parcelash që janë grupuar me marrëveshje paraprake të pronarëve për realizimin e objektit të tillë. Objekti nuk guxon të shkelë parcela të huaja, as në hapësirën ajrore e as nëntokë.

Objekti ndërtohet vetëm brenda vijës ndërtimore dhe nuk guxon të shkelë vijën ndërtimore. Daljet jashtë vijës ndërtimore janë të lejuara për katet mbi përdhese, për ballkone, strehë etj. me gjatësi të daljës max. 1.4m.

Pozita e objektit në parcel (ose grup parcelash) vendoset në atë mënyrë:

që të mos cenojë parcelat fqinje dhe vijën rregulluese;

të ketë distancë të mjaftueshme nga objektet fqinje;

Gjatë ndërtimit të objekteve të reja, pa dallim funksionit të tyre, duhet siguruar që të mos rrezikohen kushtet e jetesës së banorëve si dhe stabiliteti i objekteve në parcelat fqinje dhe rrethinë.

Gjatë ndërtimit të objekteve të reja duhet të planifikohen distanca të mjaftueshme me objektet fqinje në mënyrë që të mos dëmtojë funksionin e tyre, kushtet e diellosjes, etj. Pozita dhe lartësia e objekteve të reja në raport me rrethinën duhet të jetë e tillë që të mos pengojë ndriçimin e drejtpërdrejtë ditë diellor të objekteve në rrethinë, më gjatë se sa gjysma e kohëzgjatjes së këtij ndriçimi.

3.19 LARTËSIA E OBJEKTEVE


Lartësia e objekteve përcaktohet me numrin e kateve (etazheve) për secilin bllok veç e veç, në bazë të koeficientave të shfrytëzimit të parcelës, dhe koeficientit të ndërtimit që janë pjesë e këtij plani.

Lartësia e objekteve industriale...

Për objektet e banimit lartësia e katit të banimit mund të jetë prej 2.7-2.95m. Lartësia e lirë (hapësirë drite) nuk mund të jetë më e vogël se 2.5m për katet e banimit. Për katin përdhese me funksion afarizëm lartësia e lirë (hapësirë drite) minimale është 3.0m.

Objektet e infrastrukturës sociale kanë lartësi të kateve në varshmëri prej funksionit të tyre dhe standardeve të projektimit të objekteve të tilla.

Lartësia e objekteve të reja në raport me rrethinën duhet të jetë e tillë që të mos pengojë ndriçimin e drejtpërdrejtë ditë diellor të objekteve në rrethinë, më gjatë sesa gjysma e kohëzgjatjes së këtij ndriçimi (3.18).



3.20 DISTANCA MË E VOGËL NDËRMJET OBJEKTEVE

Distanca e objektit në raport me rrugën përcaktohet me vijën ndërtimore sipas kategorisë së rrugës.

Distanca më e vogël ndërmjet dy objekteve me fasadë ballore përballë njëri-tjetrit, orientimi very- jug, është 1.5H – ku H është lartësia mesatare e këtyre dy objekteve.

Distanca e objekteve shumëbanesore në varg, në fasadën anësore është min. 4m. Objektet shumëbanesore mund të ndërtohen në varg me distancë zero në fasadën anësore me kusht që cdo 60m të ofrohet pasazhi për depërtimin e makinës për zjarrfikje.

3.21 KUSHTET PËR NDËRTIMIN E OBJEKTEVE TË TJERA NË PARCELËN E NJËJTË NDËRTIMORE

3.21.1 KUSHTET PËR NDËRTIMIN E OBJEKTEVE TJERA

Ndërtimi i objekteve tjera në parcelën e njëjtë ndërtimore lejohet për: objektet e karakterit të përkohshëm.

- objektet e ndërtimit të ulët pa mbulesë / kulm.
- Objektet utilitare si garazha, depo etj, kur ato nuk tejkalojnë koeficientat e lejuar të sipërfaqes së ndërtimit.

3.21.2 KUSHTET PËR VENDOSJE TË ELEMENTEVE MIKRO-URBANE

a. kiosqet / makina të shitjes, bankomatet apo paisje tjera


- nuk mund të jenë të muratuar nga tullat, betoni ose elemente tjera të ngjashme ndërtimore;
- objektet duhet të jenë montazhe (për të plotësuar kriterin e largimit për 24 orë);
- vendosen në zonë e trotuarit me kushtin themelor për të mos penguar lëvizjen e lirë të këmbësorëve;

b. shenjat dhe panotë informuese

- duhet të shërbejnë për orientim brenda zonës si dhe për identifikimin e vet ndërtesës
- shenjat apo panotë informuese që identifikojnë ndërtesën duhet të vendosen në zonën e shiritit të gjelbërt brenda ngastrave mbas vijës rregulluese me qëllim që të mos pengojnë shikueshmërinë në trafik dhe të jenë të dukshme nga shtigjet e këmbësorëve;
- shenjat apo panotë informuese që identifikojnë tërë zonën ose pjesë të caktuara të zonës duhet të vendosen në zonën e trotuarit (hapësirën publike) me kusht që të mos pengojnë lëvizjen e lirë të këmbësorëve ose mund të vendosen në shiritin e gjelbër përgjatë rrugës;

c. mobiliari

- bankat për ulje duhet të vendosen në zonën e trotuarit me kushtin themelor për të mos penguar lëvizjen e lirë të këmbësorëve, poashtu ato mund të vendosen në shiritin e gjelbër përgjatë rrugës të kthyer kah trotuari;



- ndriçimi vendoset çdo 30m përgjatë gjithë rrugëve dhe duhet të ketë shtyllat jo më të larta se 6m;
- kontejnerët e mbeturinave për shërbime të ngastrave individuale, trafostacionet, matësit e ujit dhe elektrikës duhet të mëshifen aty ku është e mundur, aty ku nuk është e mundur duhet të jenë në harmoni me pejsazhin.

3.22 KUSHTET DHE MËNYRAT E SIGURIMIT TË HYRJES NË PARCELË DHE NË HAPËSIRËN E PARKINGUT

Kushtet për qasje automobilistike në ngastër janë:

- kyçja në ngastër nga rruga përmbledhëse (Kat.III) duhet të jetë min. 50 m nga rruga tjetër ;
- kyçja në ngastër nga rruga lokale (Kat.IV) duhet të jetë min. 30 m nga rruga tjetër;
- kyçjet në ngastër nga rruga për qasje (Kat.V) nuk është e kufizuar;
- Duhet të sigurohet qasje e përkohëshme për ato ngastra të cilat nuk plotësohen kushtet e lartëcekura. Qasja e automjetit me rampë (max. 10%) në garazhë nëntokësore duhet të filloj min. nga vija ndërtimore;
- Qasja e automjetit në parking të hapur duhet të siguroj një distancë minimale 2.75m të qarkullimit;
- Duhet të mundësohet qasja e automjetit të zjarrëfikësëve çdo 50 m dhe për çdo objekt.
- Duhet të mundësohet qarkullimi për lëvizjen e lirë të automjetit të zjarrëfikësëve me distancë min. 4 m (pasazh apo rrugë e hapur);
- Duhet të sigurohet lartësia e pastër prej 4 m në pasazhe të ndërtesave për qarkullim të lirë të zjarrëfikësëve.


3.23 KUSHTET PËR DEFINIMIN E RRETHOJAVE

Parcelat e blloqeve Industriale dhe ekonomike mund të rrethohen varësisht nga funksioni i tyre. Parcelat ndërtimore të ndërtesave shumëbanesore dhe ndërtesave me destinimit publik nuk duhet të rrethohen dhe ato janë përcaktuar sipas rregullave me këtë plan:

- nuk lejohet rrethimi i parcelës me gardh të ndërtesat shumëbanesore;
- nuk lejohet rrethimi i parcelës me gardh në ndërtesat publike përveç institucioneve parashkollore dhe shkollore;
- duhet të largohet gardhi apo muri kufizues i shtëpive individuale nëse pengon zgjerimin e rrugës publike;
- duhet të largohet gardhi apo muri kufizues i ndërtesave private nga hapësira publike (uzurpimi i hapësirës publike)

Parcelat ndërtimore të ndërtesave të banimit individual dhe ndërtesave arsimore mund të rrethohen sipas rregullave të përcaktuara me këtë plan:

- lejohet rrethim me gardh të objektet industriale/komerciale deri në lartësi 1.2 m (nga kota e trotuarit);
- lejohet rrethim me gardh të shtëpitë individuale deri në lartësi 1.2 m (nga kota e trotuarit);
- gardhi duhet të vendoset në vijën rregulluese, në formë që shtyllat e gardhit të gjenden brenda parcelës ndërtimore që rrethohet;



- dyert duhet të hapen brenda parcelës;
- gardhet të cilat janë të ndërtuara dhe të cilat dalin nga rregullat e përcaktuara me këtë plan duhet të ndryshohen me qëllim të ruajtjes së interesit të përgjithshëm (siguri, dukje estetike, higjienë, etj).

3.24 FORMËSIMI ARKITEKTONIK DHE ESTETIK I ELEMENTEVE TË CAKTUARA TË OBJEKTIT


Me qëllim të sigurimit të harmonisë së tërësisë urbane dhe krijimit të relacionit të shëndoshë mes ndërtesave dhe vendit duhet respektuar rregullat si më poshtë.

- kulmi mund të jetë i pjerrët apo i rrafshët;
- këndi maksimal i kulmit të pjerrët mund të jetë 35° (te ndërtesat shumëbanesore kulmi sygjerohet të mbulohet me parapet);
- nuk lejohet aplikimi i kulmit mansard;
- përdhesa preferohet të hyjë brenda vijës ndërtimore për min. 2m, duke krijuar kështu strehë pranë lokaleve dhe shteg më të gjërë të këmbësorëve;
- inkurajohet përdorimi i materialeve natyrore (tulle, gurë, e të ngjashme);
- nuk lejohet përdorimi i ngjyrave bazë, të cilat mund të jenë intensive (të papërziera me ngjyra tjera apo shkallë të përhimtë) ose të zbutura (ngjyra bazë e zbutur me ngjyrën e bardhë), inkurajohet përdorimi i ngjyrave pasteleva, ose të ngjashme;
- materialet me refleksion të madh si dritaret-pasqyrë dhe të kaltërta nuk është mirë të përdoren. Këto mund të përdoren si material sekondare apo për aksentimin e ndërtesës;
- karakteristikat arkitektonike si hyrjet dhe strehët e potencuara, të dalat në mure, fasada e xhamit, etj; hapësira të parkimit të gjelbëruara; pejsazhe të dizajnuara mire dhe fontana apo elemente tjera ujore është mirë të përdoren;
- inkurajohet arkitekturë e thjeshtë, e pastër, pa shumë detaje.

3.25 KUSHTET PËR RENOVIM DHE RIKONSTRUIM TË OBJEKTEVE EKZISTUESE

3.25.1 NDËRTESAT EKZISTUESE NË PARCELLË

- nëse ndërtesa ekzistuese e kalon vijën rregullative, dhe gjendet në koridorin e rregullimit, ajo duhet të rrënohet tërësisht apo pjesërisht (pjesa që shtrihet në koridorin e rregullimit);
- ndërtesat problematike që vështirësojnë zgjerimin e rrugëve publike nuk guxojnë të rrënohen pa marrëveshje me pronarët;
- ndërtesat ekzistuese që nuk janë në vijën ndërtimore (mbesin mbrenda ose dalin jashtë vijës ndërtimore), mund të mbahen në gjendjen ekzistuese, por pamundësohet mbindërtimi, aneks ndërtimi apo ndërtimi i ri në po të njëjtën bazë;
- nëse në kuadër të ndërtesës ekzistuese (parcelës së njëjtë) ndërtohet ndërtesë e re, atëherë ajo ndërtesë duhet t'i plotësoj kushtet e përgjithshme të rregullimit (raporti i sipërfaqes së ndërtuar dhe sipërfaqes së lirë, distanca në mes të ndërtesave, etj);



3.25.2 INTERVENIMET NË NDËRTESA

Pa kërkesë për leje mund të lejohet për:

- renovim, sanim dhe ndërrim i elementeve konstruktive, brenda gabaritit ekzistues (sanim dhe ndërrim i elementeve konstruktive nuk lejohet për ndërtesat që pengojnë zgjerimin e rrugës publike);
- kyçja në instalimet komunale, ose rekonstruimi i instalimeve të tilla;
- aneks-ndërtimi për zgjerimin e ndërtesës duhet të parashihet vetëm nëse nuk tejkalohet indeksi i sipërfaqes së shputës;
- adaptim i hapësirës brenda gabaritit ekzistues.

3.25.3 OBJEKTET QË ATAKOJNË RRUGËT


Realizimi i rrugëve të propozuara në këtë plan do ishte një zgjidhje e madhe dhe afatgjatë për banorët e kësaj lagjeje dhe lagjeve fqinje, për një të ardhme më të mirë. Janë ruajtur rrugët ekzistuese por është bërë zgjerimi i tyre në mënyrë që të plotësohen standardet dhe normativat si dhe janë hapur shumë rrugë të reja që janë të domosdoshme për funksionimin e lagjes sidomos destinimit të ri ekonomik që do ketë.

Janë analizuar objektet që takohen nga trotuari ose nga rruga që janë rreth 30 dhe mbulojnë një sipërfaqe prej rreth 2.700 m² sipas incizimit gjeodezik (v. 2009) që disponojmë ku shumica e tyre janë P+0 ose P+1.

Kompenzimi i objekteve që atakojnë rrugët dhe objekteve tjera që rrënohen për realizimin e rregullimit urbanistik të lagjes të propozuar me këtë plan duhet të bëhet në procedura të rregullta dhe me vendim komunal.



Fig. 29 Objektet që atakojnë rrugët



3.26 KUSHTET E VEÇANTA PËR NDËRTIM TË OBJEKTEVE

Në raport me funksionin e objektit përkatës për të cilin lejohet ndërtimi në zonë, duhet të përshkruhen kushtet e veçanta për ndërtimin e tij, në raport me kërkesat e këtij plani, dhe organeve përkatëse.

Me kërkesën e autoriteteve komunale dhe IMMR mund të kërkohet të kryhen hulumtime arkeologjike për lokacione të caktuara, në rast se paraqitet nevoja, apo ka indikacione për gjetje arkeologjike.

Për objektet e ndërtuara përgjatë hekurudhës duhet të mirren masa shtesë për mbrojtje nga zhurma. Objektet duhet të realizohen me fasadë dhe hapje të izoluar mirë nga ana e hekurudhës.

3.27 DENDËSIA E BANIMIT DHE DENDËSIA E NDËRTIMIT SIPAS STANDARDEVE

3.27.1 SHTIMI DEMOGRAFIK I LAGJES

Sipas Planit Strategjik Shtimi i përgjithshëm vjetor është 2,60221 % ose 26 në 1.000 banorë. Mesatarja e shtimit natyror (lindjet 18 – vdekjet 4) është 14 në 1.000 banorë.

Bilanci vjetor i migrimit është 12 në 1.000 banorë

Nga 85% të anketuarit e lagjes janë evidentuar rreth 1.200 banorë të lagjes, nëse e shtojmë duke supozuar përqindjen e ngelur rrjedh se nr. ekzistues i banoreve në lagjen e "Zona Ekonomike" është rreth 1.400 banore.

Duke u bazuar në të dhënat ekzistuese dhe në parashikimet demografike rrjedh se në lagjen "Zona Ekonomike" deri në vitin 2030 do kemi këtë rritje të popullsisë: Shtimi i popullsisë nga shtimi natyror do të jetë në v. 2020 rreth 1950 ban. dhe në v.2030 rreth 2330ban.


Plani rregullues urban "Zona Ekonomike" sipas zgjidhjes së prezentuar parashesh zhvillimin e lagjes me kapacitet prej rreth 31 mijë banorësh që do të thotë se mbulon nevojat për banim në lagje për së paku 20 vitet e ardhshme.

Lagja do të ketë një numër të banorëve të përkohshëm-punëtorëve, numri maksimal i të cilëve mund të arrijë (nëse marrim një standard dendësie 150pun/ha në zonë ekonomike) në 57 mijë.

Projeksioni i popullsisë		2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Zona Ekonomike	ban.	1,400	1,456	1,514	1,575	1,638	1,679	1,721	1,764	1,808	1,853	1,899
përqindja e rritjes	%	4.0%	4.0%	4.0%	4.0%	2.5%	2.5%	2.5%	2.5%	2.5%	2.5%	2.5%

Projeksioni i opullsisë	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
Zona Ekonomike	1,947	1,996	2,045	2,097	2,128	2,160	2,192	2,225	2,259	2,292	2,327
përqindja e rritjes	2.5%	2.5%	2.5%	1.5%	1.5%	1.5%	1.5%	1.5%	1.5%	1.5%	1.5%

Tab. 12 Projeksioni i popullsisë për v.2020 dhe 2030



3.27.2 DENDËSIA E POPULLSISË

Rritjen e dendësisë së popullsisë e shkakton shtimi intenziv i popullsisë, migrimi i popullsisë, zhvillimi ekonomik, rritja e popullsisë në qytete. Dendësia e banorëve në lagjen "Zona Ekonomike" arrinë maksimumin 689 ban/ha. në pjesën e Banimit që është veç 6% e lagjes.

Mesatryja e dendësisë së popullsisë në lagje është **154ban/ha**.

Dendësia banimore e propozuar rezulton me densifikim të lagjes dhe kjo mjafton për mbulimin e nevojave për banim në lagje në 20 vitet e ardhshme e më shumë. Dendësia banimore ndryshon varësisht prej këtyre raporteve të përcaktuar në tabelën e më poshtme.

3.28 KUSHTET QË KANË TË BËJNË ME HAPËSIRAT E LIRA TË CILAT DUHET TË MIRËMBAHEN NË APO PËRRETH NDËRTESAVE

3.28.1 RREGULLIMI I HAPËSIRAVE TË LIRA / GJELBËRIMIT

Prishtina ka 3.8 m² sipërfaqe të gjelbëruara për banorë, që është gati dhjetë herë më pak se nga rekomandimet dhe standardet botërore. Duhet që ky raport të përmirësohet dhe sipërfaqet ekzistuese të gjelbëruara të mbrohen nga ndërtimi i çdo lloj objekti, kiosku ose platoje.

Funksioni i sipërfaqeve të gjelbëruara është ajrosja e qytetit dhe përmirësimi i kushteve për jetë dhe punë në të.

Me PRRU "Zona Ekonomike" është bërë mbrojtja e fondit ekzistues të gjelbërimit dhe sipërfaqeve të destinuara për gjelbërim, pasurimi i sipërfaqeve ekzistuese, ngritja e gjelbërimit dhe raporti i rregullt me ato me qëllim të rritjes së karakteristikave funksionale dhe vizuale. Me gjelbërimin e shesheve, kryqëzimeve fitohet numër i madh i sipërfaqeve të vogla gjelbëruese të cilat e pasurojnë, hijeshojnë, pastrojnë dhe lidhin qytetin. Sipërfaqet e gjelbëruara nuk duhet të pengojnë komunikacionin me zvogëlimin e shikueshmërisë. Programi i masave për mirëmbajtjen dhe kujdesin e sipërfaqeve të gjelbëruara duhet të bëhet në bashkëpunim me institucionet e kualifikuara.


3.28.1.1 Funksioni ekologjik dhe rekreativ i hapësirave të gjelbërta

Sipërfaqja e gjelbërt e paraparë në këtë lagje është më shumë e shpërndarë në njësi të blloqeve urbane sesa në hapësira publike të mëdha ashtu që në total mbulon një sip. prej 175 ha që i bie rreth 30 % të totalit të sipërfaqes së lagjes ose rreth 20 m² për banorë/punëtor që është një standard shumë i mirë.

Kjo hapësirë e gjelbërt e lagjes do të krijojë një mikroklimë të përshtatshme për banorët dhe vizitorët e kësaj lagjeje.

Do të aplikohet stili gjeometrik dhe peisazhor i gjelbërimit, përgjatë disa rrugëve, brendësisë së blloqeve, parqeve, etj.

Zgjedhja e tipit të bimëve janë elemnt shumë i rëndësishëm që varen nga kushtet klimatike dhe pedologjike.



3.28.1.2 Sipërfaqet e gjelbëruara në blloqet e banimit

Me organizimin e kësaj hapësire do të mundësohet pushimi dhe rekreacioni brenda blloqeve për të gjitha kategoritë e banorëve. Rëndësi të veçantë duhet t'i kushtohet që me bimë të larta të pengohet rrymimi i ajrit dhe mos të krijohet hije shumë e madhe brenda blloqeve. Me kombinimin e sipërfaqeve të pllakosura dhe të gjelbëruara organizohen këndet e lojërave për fëmijë, këndet e qeta dhe këndet për rekreacion.

Gjatë ndërtimit të gjelbërimit në qytet duhet pasur parasysh largësinë e përshtatshme të bimëve dhe shkurreve nga instalimet nëntokësore.

instalimi nëntokësorë	largësia nga pemët (m)	largësia nga shkurret (m)
ujësjellësi	2	1
traseja e ujësjellësit kryesor	5	5
ngrohja	3	2
elektrika	3	2
telefoni	2	2
kolektori	3	2
kanalizimi	2	1
kanalizimi atmosferik	1	0.5
drenazhimi nën tokë	2	1


Tab. 13 Largësia e gjelbërimit nga instalimet

3.28.1.3 Trajtimi i gjelbërimit përgjatë rrugëve

- Me PRRU shirit i gjelbërimit nënkuptohet ale e drunjëve me hapësirë të caktuar të gjelbërimit të ulët;
- Hapësira e gjelbërimit të ulët përgjatë shiritit të gjelbërimit paraqet bazament për mbjelljen e drunjëve.
- Shiriti i gjelbërimit duhet të vendoset përgjatë rrugëve primare me gjërësi 1.0 m. Ky shirit kryesisht vendoset në të dy anët e rrugës (2x1.0m=2.0m);
- Distanca në mes të drunjëve duhet të jetë minimum 6 m.
- Shiriti mbrotës i gjelbërimit përgjatë rrugëve të përcaktuara në hartë ka gjerësi 22m në të dy anët e rrugës.

3.28.1.4 Hapësirat e gjelbërta dhe krijimi i shesheve të reja

- Hapësirat e gjelbërta dhe parqet e pushimit mund të krijohen brenda blloqeve të banimit varësisht prej nevojës dhe kërkesës së pronarëve;
- Sheshet mund të krijohen brenda blloqeve të banimit varësisht prej nevojës dhe kërkesës së pronarëve.



3.28.1.5 Hapësirat e sportit dhe rekreimit

- Hapësirat e sportit dhe rekreimit të propozuara me parametrat e lagjes plotësojnë nevojat optimale për banorët e lagjes;
- Hapësirat e sportit dhe rekreimit mund të krijohen edhe brenda blloqeve të banimit varësisht prej nevojës dhe kërkesës së pronarëve;
- Hapësirat e sportit dhe rekreimit në objektet e shkollave gjithashtu mund të shfrytëzohen nga banorët e lagjes.

3.28.1.6 Trajtimi i sipërfaqeve ujore

- Përrockat që kalojnë lagjen në drejtim të fshatit Shkabaj është planifikuar të kanalizohen në kanal të hapur dhe të bëhet rregullimi i tij sipas parametrave dhe standardeve të kohës.
- Kanali Ibër Lepenc brenda territorit të lagjes vendoset në gypa nëntokësor.

3.28.1.7 Përqindja e sipërfaqeve të gjelbëra në ngastër


- Gjelbërimi në kuadër të ngastrës është i detyruar dhe duhet të parashihet nga secili zhvillues i ngastrës apo grup i tyre;
- Raporti i sipërfaqes së shputës dhe të pandërtuar më së shumti është 60% - 40%.

3.28.1.8 Tipet specifike të bimëve

- Së paku një dru/ari me kurorë të gjërë duhet të mbillet për 500 m² të sipërfaqes së pandërtuar të zonës;
- Sugjerohet mbjellja e bimëve autoktone, që i përshtaten klimës dhe vendit;
- Trupat ekzistues të drunjëve nëse është e mundur duhet të ruhen;
- Duhet të parashihet largësia e duhur e drunjëve me rrënjë të mëdha nga instalimet nëntokësore.

3.28.1.9 Faktorët kryesor që ndikojnë në zgjidhjen e bimëve

- **Kushtet klimatike** – kanë ndikim gjatë zgjedhjes së bimëve dekorative sepse disa prej tyre nuk durojnë temperaturat minimale që mbizotërojnë në këtë zonë.
- **Kushtet pedologjike** – poashtu duhet bërë analizë e dheut në të gjithë sipërfaqen e kompleksit që të zgjidhen bimë që mund të adaptohen në kushtet ekzistuese pedologjike të kompleksit. Një element tjetër i rëndësishëm në zgjedhjen e drunjëve që parashihen të mbillen përgjatë rrugëve apo afër objekteve është gjerësia e kurorës dhe sistemi rrënjësorë. Nëse gjerësia nuk është adekuate degët e tyre mund të paraqesin pengesë për objektet përreth dhe poashtu mund të pengojnë qarkullimin e lirë të automjeteve kurse te bimët dekorative me zhvillim të rrënjëve në drejtim horizontal mund të dëmtojnë asfaltin e rrugëve apo trotualet. Pra, në këto raste duhet zgjedhur drunjë të cilët nuk arrijnë lartësi mbi 10 metra dhe që kanë një sistem të rrënjëve që zhvillohet kryesisht në thellësi të tokës.



3.29 KUSHTET E KYÇJES NË INFRASTRUKTURË (P.SH. FURNIZIMI ME UJË, MENAXHIMI I HEDHURINAVE TË NGURTA, HAPËSIRAT PËR PARKINGJE, ETJ.)

Të gjitha objektet e planifikuara në hapësirën e lagjes "Zona Ekonomike" kyqen në rrjetet e infrastrukturës teknike (ujësjellës, kanalizim, rrjet elektroenergjetik, TK) sipas rregullave dhe standardeve teknike për këtë qëllim, dhe sipas kushteve të përcaktuara nga Kompanitë përkatëse (KUR Prishtina, KEK, PTK) dhe pëlqimit të tyre për kyqje në rrjet.

Të gjitha objektet duhet të kenë të hapësirat e dedikuara për deponimin e hedhurinave dhe në marrëveshje me kompaninë përkatëse (KUR Pastrimi) të bëjnë largimin e tyre për në deponinë rajonale.

Të gjitha objektet në lagjen "Zona Ekonomike" duhet të ofrojnë sipërfaqe të mjaftueshme parkimi, konform parametrave të përshkruar me këtë plan. Objektet publike duhet të ofrojnë së paku 3 vendparkingje në parcelë (oborr) me qasje nga rruga, ku njëra nga këto tri parkingje duhet të jetë e standardit për veturat e personave me aftësi të kufizuar.

3.30 KUSHTET PËR VENDOSJEN E OBJEKTEVE TREGTARE, PUNËTORIVE, DEPOVE APO FABRIKAVE

Punëtori / depo / fabrika (industri).

Objektet për punëtori apo industri mund të ndërtohen në lagjen "Zona Ekonomike" me kusht që të:

Vendosen brenda parametrave të përcaktuara në indeksat e bllokut përkatës dhe zonës industriale / ekonomike në përgjithësi.


Plotësojnë kushtet teknike e sanitare dhe përgatiten në bazë të projektit profesional për ngritjen e objekteve industriale.

Nuk rezikojnë mjedisin apo shkaktojnë ndotje dhe përmbushin kushtet dhe kriteret e përcaktuara në 3.10 dhe 3.15.

Ndërtesat afariste / tregtare

Hapësirat afariste në kuadër të ndërtesave të banimit duhet të kenë raport ~25% të sipërfaqes bruto të ndërtesës së banimit.

Ndërtesat afariste duhet të kenë lartësi të pastër prej 3.6 m dhe duhet të sigurohet hapësira për 1 vendparkim në 30m².



3.31 KUSHTET PËR VENDOSJEN E OBJEKTEVE ME KARAKTERISTIKA TË VEÇANTA ARKITEKTONIKE TË DIZAJNUARA PËR QËLLIME TË VEÇANTA

Kushtet e përgjithshme për vendosjen e objekteve me karakteristika të veçanta arkitektonike të dizajnuara për qëllime të veçanta janë të njëjta me ato të prezentuara në këtë plan për objektet e përgjithshme, dhe variojnë sipas destinimit dhe parametrave të bllokut përkatësisht në të cilin parashihet të ndërtohet objekti me karakteristika të veçanta.

Kushtet e veçanta duhet të përcaktohen me detyrë konkrete projektuese nga organi projektues, investitori ose autoritetet komunale (ose të gjitha këto së bashku) me kusht që nuk dëmtojnë parametrat e përgjithshëm të rregullimit të lagjes të prezentuar në këtë plan, si dhe respektojnë kushtet për mbrojtje të mjedisit (3.10) dhe për mbrojtje nga ndotja dhe fatkeqësitë (3.15).

3.31.1 KUSHTET PËR NDËRTIMIN E OBJEKTEVE ME RËNDËSI STRATEGJIKE

Në rast të evidentimit të interesit për ndërtimin e objekteve që kategorizohen në objekte me rëndësi strategjike për komunën e Prishtinës apo Republikën e Kosovës, në lagjen Zona Ekonomike, kushtet për ndërtimin e objekteve të tilla përcaktohen nga autoriteti përgjegjës për ndërtimin e objektit në fjalë.

Kusht për ndërtimin e objekteve me rëndësi strategjike është që ato të respektojnë kushtet për mbrojtje të mjedisit (3.10) dhe për mbrojtje nga ndotja dhe fatkeqësitë (3.15).



4 VLERËSIMI I NDIKIMIT NË MJEDIS - VNM

4.1.1 TË PËRGJITHSHME

Vendi ynë është anëtar i një numri konventash ndërkombëtare, si rrjedhojë është i detyruar të zbatojë një sistem sa më efektiv në fushat ekonomiko-sociale dhe mjedisore, për rregullimin e territorit sidomos në funksion të zgjedhjes së problemeve të ndryshme mjedisore.

Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) duke u bazuar në zhvillim strategjik të Zonës ekonomike, përfshinë vlerësimin, identifikimin, si dhe përcaktimin e masave zbutëse të ndikimit të projektit në këtë zonë.

Do të paraqesim gjendjen, ndikimin e këtij plani urban rregullues mbi mjedisin e zonës dhe mbi njerëzit. Gjithashtu do të shqyrtojmë faktorët pozitiv dhe negativ mjedisor, do të paraqesim masat e rehabilitimit, masat zbutëse dhe reduktimin e impakteve negative.

Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis, shkurt (VNM) tashmë është detyrim *ligjor* për çdo projektim hapësinor apo aktivitet tjetër operativ i cili shkakton efekte të caktuara në mjedis. "**Vlerësimi i ndikimit në mjedis** i planit rregullues në **Zona ekonomike**" është një raport i shkurtër.

Ky studim përfshin një përshkrim të planit rregullues dhe ambientit ku ai është vendosur, përshkon mjediset rrethuese dhe ekosistemin të cilit i përket Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis që përfshin: informacionin e tërësishëm të kushteve fillestare të planit rregullues të zonës ekonomike, infrastrukturën e propozuar rrugore, burimet ujore, rrjetin e kanalizimit dhe trajtimin eventual të ujërave të ndotura, mbeturinat e ngurta organike e inorganike nga aktivitetet e amvisive dhe objekteve ekonomike e komerciale, si dhe ndikimet e tjera të ajrit të ndotur në lagje dhe ndikimet nga shërbimet për komunitetin e lagjes. Ai identifikon ndikimet më të rëndësishme negative, ndikimet pozitive, jep masat zbutëse dhe ato kompensuese mjedisore.

4.2 VLERËSIMI I NDIKIMIT NË MJEDIS DHE KUADRIT LIGJOR

Mbështetur në Direktivën e Bashkimit Evropian "Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis" është dhënë në mënyrë shumë të qartë se cilat veprimtari i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Kuvendi i Kosovës deri më sot ka miratuar ligje që rregullojnë mbrojtjen e mjedisit dhe natyrës dhe ato që ndërlidhen me ndikimet në mjedis. Janë rreth 30 ligje të filla të miratuara që prekin këtë fushë, por ligjet më të rëndësishme për mjedisin që zbatohen në Komunën e Prishtinës janë:



Ligji për mbrojtjen e mjedisit:

Ligji për mbrojtjen e mjedisit Nr. 03/L-025. Ky ligj identifikon autoritetet publike që do të bëjnë implementimin e një apo më shumë dispozitave të këtij ligji, krijimin e autoriteteve specifike dhe detyrimet e secilave autoritete publike që dalin nga ky ligj. Ky ligj gjithashtu do të përcaktojë të drejtat dhe detyrimet e personave apo ndërmarrjeve të prekura nga aktivitetet e autoriteteve të tilla publike apo me persona të interesuar për promovimin e mjedisit të shëndetshëm në Kosovë.

Ligji për ujërat e Kosovës:

Ligji për ujërat e Kosovës Nr.2004/ 24. Qëllimi i këtij ligji është që të sigurojë zhvillimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve ujore, të cilat janë të domosdoshme për shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin social-ekonomik të Republikës së Kosovës; të themelojë procedura dhe parime udhëzuese për shpërndarjen optimale të resurseve ujore; të sigurojë mbrojtjen e resurseve ujore nga ndotja, tejshfrytëzimi dhe keqpërdorimi; të përcaktojë kornizën institucionale për administrimin e resurseve ujore.

Ligji për mbeturinat:

Ligji për mbeturinat i Nr. 02/L-30. Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe të mjedisit nga ndotja dhe rreziku nga mbeturinat, përmes administrimit të mbeturinave, duke krijuar kushte për parandalimin dhe zvogëlimin e prodhimit të mbeturinave dhe rrezikshmërisë së tyre. Ligji rregullon përgjegjësitë dhe veprimtaritë e administrimit të mbeturinave, duke përfshirë identifikimin, klasifikimin, planifikimin, organizimin dhe përcaktimin e kushteve për veprimtaritë e administrimit të mbeturinave, lëshimin e liçensave për administrimin e mbeturinave dhe caktimin e kushteve të pranueshme mjedisore, për veprime me mbeturina.

Ligji për vetëqeverisje lokale:


Ligji për vetëqeverisje lokale Nr. 03/L-040. Ky ligj përkufizon statusin ligjor të komunave, kompetencat dhe parimet e përgjithshme të financave komunale organizimin dhe funksionimin e organeve komunale, marrëdhëniet brendakomunale dhe bashkëpunimin ndërkomunal, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkufitar dhe marrëdhëniet ndërmjet komunave dhe pushtetit qendror.

Ligji për mbrojtjen e natyrës:

Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr. 03/L-233, Ky Ligj rregullon mbrojtjen e natyrës, shfrytëzimin e qëndrueshëm të saj. Veçanërisht mbrojtjen, ruajtjen, përtëritjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore, në gjendje të baraspeshës natyrore;

Ligji për planifikimin hapësinor

Ligji për planifikimin hapësinor 2003/14. Me këtë ligj rregullohen: kushtet dhe mënyra e planifikimit, rregullimit dhe zhvillimit të hapësirës, caktohen llojet dhe



përmbajtja e planeve, hartimi dhe procedura për nxjerrjen e planeve, përcaktohen kompetencat e organeve qendrore dhe organeve të administratës lokale për nxjerrjen dhe zbatimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor, mbikëqyrja e zbatimit të ligjit si dhe masat dhe aktivitetet me të cilat sigurohet planifikimi dhe rregullimi i hapësirës së Kosovës.

Ligji për pyjet e Kosovës:

Ligji për pyjet e Kosovës Nr. 2004/29. Pyjet e Kosovës janë resurse kombëtare. Do të udhëhiqen në atë mënyrë që të ofrojnë rendimente me vlerë dhe në të njëjtën kohë të ruhet biodiversiteti për të mirën e gjeneratave të tashme dhe të ardhshme. Udhëheqja e pyjeve do të marrë parasysh gjithashtu edhe interesat e tjera publike.

4.3 METODA E PREGATITJES SË VNM

Metodologjia e përdorur për përgatitjen e raportit të VNM-së u bazua në:

- Rishqyrtimin e politikave, rregullave, udhëzimeve operacionale dhe masave organizative institucionale ekzistuese në Kosovë për të zgjidhur dhe lehtësuar impaktet shoqërore dhe mjedisore të studimit;
- Vlerësimin e përputhshmërisë së parimeve bazë të rregullave shqiptare duke identifikuar boshllëqet dhe duke paraqitur rekomandime për t'i zgjidhur ato;
- Përgatitjen e udhëzimeve për identifikimin dhe vlerësimin e natyrës dhe magnitudës së impakteve mjedisore dhe sociale, duke përfshirë përgatitjen e kriterëve seleksionuese sociale dhe mjedisore;
- Sugjerimet mbi modalitetet për përgatitjen e masave lehtësuese të planit rregullues në lidhje me zonën ku po ekzekutohet ky i fundit.

4.4 PËRSHKRIMI I “ZONËS EKONOMIKE”

“Zona Ekonomike” përfshinë një sipërfaqe prej 574 ha, dhe shtrihet në pjesën veriperëndimore të qytetit të Prishtinës. “Zona Ekonomike” në Veri kufizohet me Bërnicën, në Lindje me Kodrën e trimave, “Kosova filmin” pastaj me zonën e urbanizuar “Arbëria 3”, në Jug me Fushë Kosovën, në Perëndim me fshatin Shkabaj.




Fig. 30 Zonat e lagjes "Zona Ekonomike"

Me planin rregullues është paraparë që "Zona Ekonomike" të ndahet në disa destinime dhe ato janë dhënë në tabelën e mëposhtme:




	destinimi	Sip. (ha)	perqindja	ISHP	ISD	S.Perdhese	S. tot. nderit.	S. gjelberimi	nr. Ban.	nr.Pun.
ZI	Zone Industriale	87.7	15.3%	0.40	1.20	350,678	1,052,035	350,678		13,150
ZIm	Zone Industriale Mikse	36.0	6.3%	0.40	1.20	144,088	432,265	144,088		5,403
ZK	Zone Komercale	246.7	43.0%	0.40	1.20	978,204	2,934,613	978,204		36,683
ZKm	Zone Komercale mikse	16.0	2.8%	0.40	1.20	64,094	192,282	64,094		2,404
ZMb	Zone Mikse Banim	21.6	3.8%	0.40	1.80	86,431	388,941	86,431	7,439	
ZBk	Zone Banimi Komercale	34.1	5.9%	0.40	2.40	136,433	818,600	136,433	23,484	
E	Shiriti Mbrojtes - E	65.0	11.3%	0.00	0.00	0	0	65,050		
Sip. neto (ZI+ZK+ZKm+ZM+ZB+E)		507.2	88.4%	0.50	1.65	1,759,930	5,818,737	1,759,995	30,922	57,640
Sip. Rrugeve		66.8	11.6%							
Siperfaqja sipas kufirit		612.0								88,562
Siperfaqe totale e trajtuar		574,076	100.0%							

Tab. 14 Parametrat e blloqeve

Duke u bazuar në kërkesat dhe nevojat e vendit tonë degët në zonën industriale të mëposhtëshënuara janë potencial dhe duhet të zhvillohen në të ardhmen: industria ushqimore, industria e gomës dhe plastikës, industria metalike, industria e mineraleve jo metalike, industria e drurit, industria kimike, Industria përpunuese, industria e tekstilit, etj.

Varësisht nga konfigurimi nevoja dhe strategjia e zhvillimit do të organizohen edhe degët e zhvillimit ekonomik nëpër blloqe si: tregtia me shumicë dhe pakicë, riparim i automjeteve, hoteleri, restorante, ndërtimtari, transport, depo, telekomunikacion, bujqësi, gjueti, pylltari, etj.

Zona e Banimit shtrihet në pjesën qendore të lagjes skaj rrugës rajonale Prishtinë-Mitrovicë. Të gjitha objektet ekzistuese janë analizuar dhe ato që është parë e arsyeshme që të mbesin do të korporohen me pjesën e banimit në Arbëri dhe me banimin në fshatin Shkabaj.



4.5 VLERËSIMI I GJENDJES SË MJEDISIT

Studimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) siguron një përmbledhje të dhënave ekzistuese dhe informacion mbi kushtet e planit rregullues të zonës ekonomike duke përfshirë kushtet fizike atmosferike, burimet ujore dhe biologjike, burimet kulturore dhe gjendjen social-ekonomike të zonës. Në procesin studimor të VNM përdoren informacioni, të dhënat ekzistuese dhe të përfituara rishtas mbi kushtet e planit rregullues të zonës ekonomike, së bashku me standardet dhe normat e zbatueshme për të vlerësuar impaktet potenciale mjedisore dhe sociale të fasiliteve të propozuara.

Ajri- Hulumtimet e ndryshme dhe të dhënat nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik mbi gjendjen e ajrit në Komunën e Prishtinës, tregojnë që gjendja e ajrit në komunë është në kufirin e epërm të lejuar të disa parametrave përcaktues të ndotjes së ajrit. Prandaj, edhe "Zona ekonomike" është e ndikuar nga gjendja e përgjithshme e ajrit të Prishtinës. Burimi kryesor i ndotjes së ajrit në këtë zonë është deponia e hirit dhe Korporata Energjetike e Kosovës. Për të patur qasje më të saktë të gjendjes së ajrit është e nevojshme të ngriten disa pika të monitorimit të ajrit në këtë zonë, ku do të përcilleshin disa parametra themelor të ndotjes së ajrit.


Bujqësia - Niveli bujqësor në këtë zonë është i lartë për shkak të sipërfaqeve së shumëta të tokës dhe produktivitetin e lartë të tyre. Sistemet e drenazhimit dhe të vaditjes janë të mira, në këtë zonë kalon kanali i ujitjes Ibër Lepenc i cili është funksional.

Bimësia - në këtë zonë gjenden lloje të ndryshme të bimëve në ara, livadhe dhe pyje. Në pjesën veriore në disa zona ka pyje jo shumë të dendura kryesisht pyje të reja.

Fauna- bota shtazore në këtë vend është shumë e pasur. Nga kafshët shtëpiake hasim lopët, delet, kuajt, mirëpo kohëve të fundit përveç lopëve dhe disa kuajve, asnjë ekonomi familjare nuk mbajnë kafshë të tjera.

Ujësjellësi - Furnizimi aktual i lagjes "Zona Ekonomike" me ujë të pijes është nga burimet sipërfaqësore nga liqeni i Batllaves i cili furnizon rezervuarin Arbëria, Kodra e Trimave I dhe Kodra e Trimave II, ku uji nga rezervuari i Arbërisë furnizon pjesën e Zonës Ekonomike.

Kanalizimi- Për momentin nuk ka impiant për trajtimin e ujërave të zeza në këtë zonë. Banorët të cilët jetojnë në këtë zonë nuk janë të kyçur në sistemin e kanalizimit. Është paraparë nga studimi i vizibilitetit për ujë dhe kanalizim për qytetin e Prishtinës në të ardhmen të ndërtohet Fabrika për trajtimin e ujërave të zeza që do të ndërtohet në Fushë Kosovë, në këtë fabrikë do të trajtohen ujërat e zeza nga Komuna e Prishtinës me disa fshatra përreth, Fushë Kosova



dhe Kastrioti. Poashtu edhe ujërat e zeza nga Zona industriale (zona e banimit dhe ekonomike) do të kyçen në këte tubacion që është i paraparë nga Fshati Shkabaj në drejtim të Kastriotit në Fabrikën për përpunimin e ujërave të zeza në Fushë Kosovë, ndërsa ujërat e përdorura nga zona industriale së pari të trajtohen në afërsi të zonës industriale pastaj të vazhdojnë deri të rrjeti që shkon për Fushë Kosovë.

Energjia -Burimet energjitike sigurohen nga sistemi energjetik kombëtar (KEK). Burime të tjera energjitike në këtë zonë për momentin nuk ka.

Mbeturinat- Duhet të aplikohet sistemi i ndarjes së mbeturinave organike dhe inorganike dhe në mënyrë të veçantë ndarja e materieve të rrezikshme. Largimi i mbeturinave të bëhet konform sasisë së hedhurinave që krijohen në këtë zonë. Momentalisht në këtë zonë nuk ka kontejnera për grumbullimin e mbeturinave.

Zhurmat -Trafiku automobilistik është i konsiderueshëm, përgjatë rrugës kombëtare Prishtinë - Mitrovicë, por ai nuk është shqetësues për zonën, sepse ajo kalon në pjesën perëndimore të zonës industriale.


4.6 NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS DHE MASAT E PROPOZUARA PËR PARANDALIMIN DHE ZBUTJEN E TYRE.

Një nga objektivat e këtij studimi është identifikimi i ndikimeve të mundshme që mund të shkaktohen në mjedis nga ky planifikim hapësinor në tërësi. Identifikimi i ndikimeve të mundshme në mjedisin e kësaj zone do të vlerësohen në dy prej fazave kryesore siç janë; gjatë projektimit dhe gjatë implementimit.

Ndikimet mjedisore në zonën e banimit

Gjatë projektimit të zonës industriale do të bëhen intervista të gjëra dhe do të diskutohet me anëtarët e komunitetit. Ata duhet të përfshijnë sa më shumë që është e mundur anëtarë të komunitetit. Këto diskutime me komunitetin bëhen për këto qëllime:

- Për të siguruar se projekt-propozimi me të vërtetë reflekton prioritetet e anëtarëve të ndryshëm të komunitetit dhe se e ka përkrahjen e plotë të komunitetit;
- Të këshillojë komunitetin lidhur me përfitimet, koston dhe ndikimin në mjedis (nëse ka) të implementimit të varianteve të ndryshme si dhe kërkesat që duhet plotësuar;
- T'i identifikojë nevojat e komunitetit për trajnime dhe ngritjen e kapaciteteve.



Ndikimi në mjedis gjatë ndërtimit të rrugëve

Përmirësimi i rrugëve për të shkuar në sheshin e ndërtimit të Zonës ekonomike së bashku me infrastrukturën përkatëse është një distancë shumë e shkurtër për t'u lidhur me rrugën kryesore Prishtinë – Mitrovicë. Për pasojë gjatë përmirësimit të kësaj distance shumë të shkurtër të rrugës do të kemi emetim pluhuri në sasira shumë të vogla në atmosferë si rezultat i punimeve të ndryshme që duhet të bëhen në të.

Ndikimi në mjedis si rezultat i largimit të materialeve

Bazuar në kuotat jo shumë të ndryshueshme të vendit ku do të ndërtohet "Zona Ekonomike" së bashku me infrastrukturën përkatëse tregohet se nuk kemi të bëjmë me shumë materiale që do të largohen nga sheshi. Megjithatë një sasi e madhe dhe e gërmuar do të largohet nga sheshi dhe duhet të depozitohet në vende të caktuara, ndërsa atje ku do të hidhet nuk duhet të shkaktojë ndotje të tjera të mjedisit.

Monitorimi i mjedisit gjatë implementimit të Zonës industriale

Programi i monitorimit do të përdoret për të verifikuar të gjitha ndotjet e mundshme që do t'i vijnë mjedisit nga ndërtimi dhe operimi i Zonës ekonomike së bashku me infrastrukturën përkatëse, e të cilat janë marrë parasysh. Kjo do të lejoj ndjekjen e programit dhe marrjen e masave korrigjuese përpara se ndonjë dëm potencial të bëhet realitet.



5 ANALIZA EKONOMIKE


HYRJE

Vitin 2008, Kosova e filloi me ngjarjen më të ndritur në historinë e saj, kur Kuvendi i Kosovës shpalli Pavarësinë e Republikës së Kosovës më 17 Shkurt 2008. Ndërsa, më 9 Prill 2008 Kuvendi i Republikës së Kosovës aprovoi dhe më 15 Qershor 2008, hyri në fuqi Kushtetuta e Republikës së Kosovës, si akti më sublim për respektim të demokracisë, lirisë dhe të drejtave themelore bazuar në vlerat më civilizuese perëndimore. Me shpalljen e Republikës së Kosovës si shtet i pavarur dhe me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së Kosovës, u vendosën themelet për zhvillim të një shoqërie prosperuese, të qëndrueshme politikisht dhe ekonomikisht me qëllim të integritimit rajonal dhe evropian, dhe krijimit të Kosovës si faktor stabiliteti dhe bashkëpunimi në rajon. Në aspektin ekonomik, ngjarje e rëndësishme ishte mbajtja e Konferencës së Donatorëve në Bruksel dhe zotimet e donatorëve për përkrahje financiare të Kosovës në vlerë prej 1,2 miliard euro. Poashtu, u inicua anëtarësimi në institucionet më të rëndësishme ndërkombëtare financiare si në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Bankën Botërore. Edhe viti 2008 për Kosovën, ishte vit i sfidës sa i përket shtimit të zhvillimit ekonomik. Këtë sfidë e bëri sidomos të paparashikueshme edhe kriza financiare dhe ekonomike globale që tronditi ekonominë botërore. Kriza, poashtu u reflektua edhe në zvogëlimin e përqindjes së remitancave dërguar në Kosovë, dhe poashtu, u prek edhe eksporti i Kosovës për shkak të lëvizjes së cmimeve në tregjet e kapitalit. Në aspektin e krijimit të një ambienti më të favorshëm për zhvillimin e biznesit, faktor pozitiv ishte inicimi dhe pranimi i kërkesave të OEK-ut dhe të komunitetit të biznesit për reformim të politikës fiskale. Kështu, qeveria dhe Kuvendi aprovuan ndryshimet e politikës fiskale që hyn në fuqi nga 01 Janari 2009.

5.1 KOSOVA

Kosova gjendet në Evropën Juglindore, e karakterizon pozita qendrore në Gadishullin Ballkanik. Kufizohet me: Shqipërinë (112 km gjatësia e kufirit), Maqedoninë (159 km), Serbinë (352 km) dhe Malin e Zi (77 km). Shtrihet në Gjerësi gjeografike veriore prej 43°16' në Gjerësinë jugore 41°53', në Gjatësinë lindore 21°16' dhe Gjatësinë perëndimore 19°59'.





Sipërfaqja e Kosovës është 10.887 km², në të cilën jetojnë mbi 1.733.872 banorë (sipas Regj. 2011 të dhënat paraprake), dhe paraqet hapësirë me dendësi të madhe të popullsisë (175 banorë në 1 km²). Kosova është e rrethuar me male të larta, disa kreshta malore kalojnë edhe mbi 2000 m lartësi mbidetare (maja më e lartë Gjeravica 2.656m). Malet nuk e izolojnë Kosovën nga vendet e tjera, sepse në të katër anët lumenjtë kanë prerë lugina të gjera dhe të thella lumore, duke i tejkaluar këto barriera natyrore, dhe duke e vënë Kosovën në funksion lidhës në brendësinë e Gadishullit Ballkanik dhe deteve që e rrethojnë. Bujqësia është veprimtaria kryesore ekonomike, me dendësi të madhe agrare, me mekanizim të pamjaftueshëm, me strukturë të pavolitshme për kultivimin e kulturave etj. Toka bujqësore janë 53% dhe 39.1% pyje, rreth gjysma e tokës bujqësore (52.3%) është e lërueshme, kurse një e treta (31%) janë kullosa. Industria gjendet në fazën e tranzicionit. Një profil i fillë ekonomik ka kushtëzuar dominimin e popullsisë rurale ndaj asaj urbane.) Për nga mosha popullsia e Kosovës është e re, ku dominon mosha nën 19 vjeç dhe atë me 42.5%. Kryeqyteti i saj është Prishtina, kurse qytetet e tjera të mëdha janë: Prizreni, Mitrovica, Peja, Gjakova, Gjilani dhe Ferizaji.

5.2 DEMOGRAFIA DHE ZHVILLIMI SOCIAL

5.2.1 NUMRI I POPULLSISË


Në Kosovë jetojnë 1.733.872 banorë. Ky numër është relativisht i madh në një sipërfaqe prej 10.887 km² sa ka Kosova. Rritja e numrit të popullsisë është 1.3 % vjetore, që është më e larta në rajon. Gjatë periudhës 60 vjeçare (1921-1981) popullsia është rritë për 3.6 herë. Vlerësimet e ESK për vitin 2011 kanë dhënë shifrën prej 2.2 mil banorëve, por sipas regjistrimit kjo shifër ka rezultuar të jetë 1,733,872 banorë resident në Kosovë.

5.2.2 DENDËSIA E POPULLSISË

Kosova për nga dendësia e popullsisë renditet ndër vendet e para në Evropë me rreth 175 b/km². Pas luftës kemi një migrim të madh të banorëve nga zonat rurale në qendrat urbane ku na qfaqet një urbanizim i dhunshëm në Kosovë. Për dallim nga qytetet e tjera, Prishtina si kryeqendër është vendi ku graviton jo vetëm popullsia e fshatrave përreth por nga mbarë viset e Kosovës, që pason me shkeljen e normave të jetës urbane. Dukuritë e tjera negative janë: fokusimi i popullsisë në qendra urbane, zgjerimi horizontal dhe pa plan i qyteteve, shfrytëzimi joracional i tokës bujqësore, mungesa e infrastrukturës, ndotja e mjedisit.

5.2.3 SHTIMI NATYROR I POPULLSISË

Norma e shtimit të popullatës ka qenë si vijon: 1961-2.1%, 1971-2.6%, 1981-2.5%, 1991-2.1%. Popullata e Kosovës ende mbetet njëra ndër popullatat me shtim më të lartë në rajon. Shkalla e shtimit natyror është rreth 13 ‰ në vit. Shkalla e madhe e shtimit natyror të popullsisë është faktori kryesor që ka ndikuar në numrin dhe dendësinë e popullsisë si dhe problemet që rrjedhin prej tyre. Raporti në mes të përqindjes së gjinisë mashkullore dhe femërore është 50.38 % meshkuj dhe 49.62 % femra .



5.2.4 POPULLSIA SIPAS GRUPMOSHAVE

Gjysma e popullsisë në Kosovë është nën moshën 20 vjeç. Në Kosovë kategoria e popullsisë së re (prej 0-14 vjeç) është përfaqësuar me 37.4 %. Pjesëmarrja e popullsisë së moshës 15-64 vjeç është 58 %. Popullsia e moshës mbi 64 vjeç përfshin vetëm 4.6 %.

Dominimi i strukturës së re të popullsisë ndikon në shkallën e lartë të shtimit natyror.

5.2.5 POPULLSIA SIPAS ETNITETEVE

Në Kosovë jetojnë etnitete të ndryshme. Rreth 89% e popullsisë janë shqiptarë, serbë 6.3 %, romë 1.3 % dhe të tjerë 3.4 %.

5.2.6 JETËGJATËSIA MESATARE

Gjatë viteve nëntëdhjetë, jetëgjatësia mesatare për Kosovën është zgjatur për gati 30 vjet, në krahasim me vitet pesëdhjetë (prej 46 deri 74 vjet).

5.2.7 GJENDJA SOCIALE

Vlerësohet se numri total i të punësuarve në Kosovë është rreth 260 mijë, prej tyre rreth 61 mijë janë të punësuar në ndërmarrje shoqërore, rreth 125 mijë në ndërmarrjet private, rreth 65 mijë në sektorin qeveritar dhe rreth 18 mijë në organizatat e huaja dhe OJQ-të. Numri i madh i të punësuarve në Kosovë është edhe në sektorin joformal.

5.2.8 PAPANËSIA


Një ndër sfidat kryesore për popullatën e Kosovës është shkalla e lartë e papunësisë. Kosova është vendi me shkallë më të lartë të papunësisë në rajon. Kjo normë e papunësisë sillet rreth 49 %. Norma e papunësisë për femra në Kosovë është më e lartë sesa për meshkuj, rreth 63 %, ndërsa për meshkuj rreth 40 %. Shumica e atyre që janë pa punë janë të moshës 16-24. Ky grup i personave të papunë përbën rreth 40 % të numrit total të të papunëve.

5.2.9 SHKALLA E VARFËRISË

Hulumtimet e kohëve të fundit tregojnë se varfëria në Kosovë është gjerësisht e përhapur më tepër se gjysma e popullatës (36 %) jeton në varfëri, kurse 16 % e popullatës jeton në varfëri ekstreme. Shkalla e ulët e zhvillimit ekonomik, procesi i ngadalshëm i privatizimit, shkalla e lartë e papunësisë, sidomos tek të rinjtë, janë faktorë kryesorë të shkallës së lartë të varfërisë. Kjo shkallë e lartë e varfërisë është shkaktuar nga shkatërrimet e luftës dhe shkallës së lartë të papunësisë.

5.2.10 MESATARJA E ANËTARËVE TË FAMILJES

Madhësia mesatare e familjes në Kosovë është 5.88 anëtarë, e cila ndryshon sipas rajoneve. Në Kosovë, sidomos në viset rurale (fshatra), familjet janë më të mëdha se në qytete. Në mesataren e madhe të familjes në Kosovë kanë ndikuar edhe faktorët



tjerë kulturorë, socialë dhe ekonomikë. Krahas me përmirsimin e standardit jetësor, mesatarja e anëtarëve të familjës është zvogëluar vazhdimisht.

5.2.11 BANIMI

Banimit është çështje vendimtare për stabilitet social, shëndet, si dhe për zhvillimin e kualitetit të jetesës. Kosova në vitin 2011 ka pasur rreth 403459 mijë objekte të banimit të të gjitha llojeve, në të cilat kanë jetuar rreth 295 mijë ekonomi familjare apo rreth 1.733.872 banorë.

5.2.12 ARSIMI

Në Kosovë që nga viti 2000 ka filluar të aplikohet sistemi i ri i arsimit I klasifikuar sipas ISCED 9719, brenda të cilit ka 6 nivele të arsimit. Rrjeti shkollor është i organizuar në shkolla kryesore dhe paralele të ndara fizike. Mësimi mbahet në pesë gjuhë: në gjuhën shqipe, serbe, boshnjake, turke, kroate dhe të përziera. Kosova ka një universitet publik të themeluar në vitin 1970 me seli në Prishtinë. Përbrenda këtij universiteti ekzistojnë 21 fakultete dhe shkolla që ofrojnë studime universitare në 57 fusha të specializimit. Prej tyre 14 fakultete ofrojnë studime pasuniversitare në mëse 30 fusha.

5.2.13 SHËNDETËSIA

Popullata kosovare ende ka nevojë për shërbime mjeksore jashtë vendit. Shëndeti përcakton drejtëpërdrejt aftësinë e shoqërisë për të marrë pjesë në të gjitha sferat e jetës shoqërore, politike dhe ekonomike. Shërbimet shëndetësore publike në Kosovë kryhen në tri nivele: në shërbimin parësor, shërbimin dytësor dhe në shërbimin tretësor, po ashtu kemi edhe shërbimet shëndetësore private. Si institucione shëndetësore kemi edhe institutet në nivel qendror dhe ato rajonale (Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, Instituti i Transfuzionit)

5.2.14 MJEDISI DHE SHFRYTEZIMI I TOKËS

Territori i Kosovës shtrihet në lartësi mbidetare në mes të pikës më të ulët 265m - në Vërmicë në derdhje të Drinit Bardhë dhe pikës më të lartë 2656 m-Maja e Gjeravices, në Bjeshkët e Nemuna. Relievi në Kosovë dallohet me vise të larta (Bjeshkët e Nemuna-Alpet Shqiptare), Malet e Sharrit: (Me Kopaonikut dhe M. Qendrore) dhe vise të ulëta (Rrafshi i Dukagjinit dhe Fusha e Kosovës me disa lugina lumenjsh).

5.3 KONTEKSTI SOCIO- EKONOMIK I KOSOVËS


Performansa ekonomike e Kosovës vazhdon të jetë e varfër. Llogaritjet e rritjes ekonomike nga 2006-4%, 2007-4%, 2008-5%, 2009-4%, 2010-4.8% etj. Vlera e Bruto Produktit Vendor (BPV) për kokë banori vlerësohet të jetë mes 1,822 euro dhe 2,383 euro. Periudha e krizës e vitit 2008 tregon rritje të ndjeshme të inflacionit në shkallë 9.3%. Ky numër është shumë më i lartë krahasuar me atë të BE (3.9%) dhe EJL (7.6%)



gjatë periudhës së njëjtë. Sipas MEF, çmimet e lartatë naftës dhe ushqimit në tregjet botërore janë shkaqet kryesoretë rritjes së inflacionit, për arsye se Kosova është shumë e varur nga importi. Deri në mes të vitit 2008, burimet e akumuluar nga privatizimi arritën në 383 milion euro ose 11.5 % të BPV. Burimet vazhdojnë të mbahen në Fondin Agjensionit Kosovar të Mirëbesimit, të ngrira dhe jashtë aktivitetit ekonomik, edhe pas zëvendësimit të Agjensionit të Mirëbesimit i cili udhëhiqej nga ndërkombëtarët me Agjensionit Kosovar të Privatizimit. BPV sipas viteve është si vijon: 2004- 2,912.5 mil., 2005- 3,002.9 mil., 2006- 3,120.4 mil., 2007- 3,393.7 mil., 2008- 3,851.4 mil., 2009-3,912.4 mil. dhe më 2010 – 4,215.6 mil. Shif tabelën 1 më poshtë.

BPV sipas viteve

Tabela 1




5.4 CILËSIA E BURIMEVE NJERËZORE

Kosova zotëron burimet njerëzore relativisht të kualifikuara. Edhe pse në vend ka mjaft kapacitete njerëzore teknike të një cilësie të pranueshme akoma mungojnë kapacitete të mjaftueshme menaxheriale për mjaft degje të industrisë. Kur behet fjale për koston e fuqisë punëtore, mund të thuhet se ajo është akoma e lire, krahasuar kjo me atë në disa vende tjera të rajonit. Prodhimi industrial në Kosovë në fillim të këtij shekulli ishte pothuaj inekzistent. Kjo për arsye kryesisht edhe të luftës. Menjëherë me vendosjen e administratës ndërkombëtare, rendit e qetësisë, dhe sidomos pas formimit të qeverisë së parë provizore në vend, filluan të duken shenjat e para të fillimit e rifillimit të disa prodhimeve të rëndësishme industriale në vend.

Edhe pse shumica e prodhimeve industriale akoma sot importohen, tendencat për zëvendësimin e tyre me prodhime vendi është mjaft e qarte.

Gjate 3-4 viteve të fundit janë hartuar e miratuar një sere ligjesh e rregullash themelore dhe jetike për krijimin e tregjeve kompetitive për produkte industriale në Kosovë. Në përgjithësi konstatohet se në Kosovë ka mjaft kapacitete prodhuese të pashfrytëzuara. Mobilizimi i tyre varet ndër të tjera edhe nga:



- 1-procesi i ngadalshëm i privatizimit,
- 2-vështirësia për hyrjen në tregjet e vendeve të rajonit e me gjere,
- 3-furnizimi jo i rregullt me energji elektrike,
- 4-ne mjaft traste nevoja për rinovim teknologjik,
- 5-mungesa e programeve mbështetëse me asistencë e financim.

Me rendësi është të përmendim se në Kosovë ekziston mjaft fuqi e lire punëtore relativisht e shkolluar. Është fakt se papunësia është në një nivel mjaft të lartë, ndërsa kostoja e krahut të punës relativisht mjaft e lirë. Kjo do të kërkonte që Qeveria të hartojë e miratojë strategji e programe konkrete mbështetëse në dy drejtime kryesore:

- 1-krijimin e mjedisit të përshtatshëm për prodhimin e tregtimin e produkteve—pra një ekonomi e treg të hapur e të ndershëm;
- 2-nxitje e financimeve private nëpërmjet zhvillimit të sektorit financiar vendor dhe garantimit real të investimeve dhe
- 3-ndërtimit të infrastrukturave të tjera baze fizike dhe institucionale për mbarëvajtjen e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm nëpërmjet aktivizimit sa më shumë të sektorit privat në të.

5.5 PRISHTINA


Prishtina gjendet në pjesën veriperëndimore dhe shtrihet buzë rrafshnaltës së pllëshme rrëzë maleve të argjendta dhe ka 572 km², ndërsa ka 200 mijë banorë (Regj. 2011). Ashtu si dikur Ulpiana, ka pozitë të përshtatshme gjeografike, pasi gjendet në kryqëzimet parësore kontinentale. Komuna e Prishtinës i ka gjithësej 48 fshatra. Komunitetet që jetojnë në Komunën e Prishtinës janë: serb, turk, boshnjak, rom, etj.

Në komunën Prishtinës operojnë rreth 13,306 biznese. Numri më i madh i këtyre bizneseve janë të orientuara në veprimtaritë tregtare. Bazuar në të dhënat e MTI, rreth 54% e bizneseve merren me tregti dhe hoteleri, 15% me transport, 8% me patundshmëri dhe vetëm 4% me veprimtari përpunuese.

Kjo tregon për një shpërndarje jo të volitshme sipas sektorëve të bizneseve në Komunën e Prishtinës sektori i bujqësisë, gjuetësisë dhe pylltarisë përshinë 27 biznese. Në sektorin e industrisë nxjerrëse ekzistojnë 16 biznese. Sektori i furnizimit me energji elektrike, gas dhe ujë numëron 5 biznese, ai i ndërtimtarisë me 329 biznese, ndërsa ai i tregtisë me shumicë dhe pakicë 4.203 biznese. Po ashtu edhe biznesi i hotelarisë po avancohet përditë e më shumë dhe kështu në Komunën e Prishtinës aktualisht ekzistojnë 781 restorante dhe hotele.

5.6 ZHVILLIMI I INDUSTRISE

Kosova deri me 1990 ka arrit të ngrisë një industri me dominim të nënsektorëve të prodhimit të metaleve dhe produkteve prej metali (metalurgjia e zeze dhe e ngjyrosur), produkteve të plastikës dhe gomës, produkteve kimike, pjesë të automobilave, produkte ushqimore si vere dhe pije tjera. Pjesëmarrja e industrisë në Bruto Produktin e Përgjithshëm (GDP) gjate 1988 deri me 2004 ka rënë nga 47 në 15 për qind. Kjo rënie sistematike e prodhimit industrial ishte pasoje e një konflikti të mbyllur që zgjati nga viti 1989 deri kur konflikti merr përmasa të një lufte (1999).



Si shtese, kësaj rënie të industrisë, mes 1991-1999 i kanë kontribuar sanksionet ndërkombëtare, dhe izolimi i Jugosllavisë..Sa për ilustrim, prodhimi industrial(Federal statistical Office of Yugoslavia, 2001) në mes të 1990-1999 bie afërsisht 60%. Për disa vite industria ka operuar me kapacitet ndërmjet 10-30 %. Disa industri edhe janë mbyllur, vendosja e paqes me 1999 shënon një kapitull të ri për Kosovën.

5.6.1 GJENDJA E PRODHIMIT INDUSTRIAL

Nga shqyrtimi i të dhënave në anketë vërehet se peshën kryesore të prodhimit në vlerë e mbajnë sektorët, industria ushqimore (37.5%), e gomës dhe plastikes (19.06%), metalike (13.63%), mineraleve jo metalike (10.45%),drurit (3.42%), dhe ajo kimike (3.42).Për sa i përket punësimit, numrin më të madh në punësim e kanë ndërmarrjet e sektorit të industrisë ushqimore (32.2%), ajo e gomës dhe plastikes (4.60), industria jo-metalike (16.43), industria metalike (16.74).Rajoni i Gjilanit ka numrin më të madh të ndërmarrjeve, të punonjësve, dhe të prodhimit të përgjithshëm të shprehur në Euro. Ky rajon përbën gati 34% të prodhimit e punësimit industrial. Menjëherë pas Gjilanit vjen Rajoni i Prishtinës me rreth 29% të prodhimit të përgjithshëm. Pastaj me radhë vijnë rajonet e Prizrenit, Pejës, dhe Mitrovicës. Rajoni i Prishtinës edhe pse kontribuon me rreth 29% në prodhimin e përgjithshëm industrial vendor, numri i punonjësve të angazhuar në këtë prodhim është vetëm 13% e numrit të përgjithshëm të angazhuar në industri.

5.6.2 PRIORITETET STRATEGJIKE PËR ZHVILLIMIN INDUSTRIAL NË KOSOVË


Mbështetja për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e social nëpërmjet nxitjes së sektorit prodhues kompetitiv vendor si një nga drejtimet kryesore për rritjen e punësimit, përdorimit efektiv të burimeve natyrore e njerëzore vendore, dhe rritjen e eksporteve me synim reduktimin e deficitit tregtar.Hartimi dhe zbatimi i politikave të integruara e strategjive adekuate që do të mundësojnë krijimin e mjedisit të përshtatshëm dhe kushteve të favorshme për nxitjen e zhvillimit të industrisë kompetitive në Kosovë.

5.6.3 PROGRAMI PËR MBËSHTETJEN E ZHVILLIMIT TË ZONAVE INDUSTRIALE NË KOSOVË

Synimi kryesor i këtij programi do të ishte definimi i rregullave dhe vendosja e kushteve për ofrimin e subvencioneve qeveritare ndaj komunave dhe ndërtuesve në formë të subvencionit direkt, subvencionit me kamatë dhe në formë të ndihmës financiare të kthyeshme nga buxheti i shtetit.Programi mund të përfshijë katër nën-programe:

5.7 ZHVILLIMI NË FUSHEN E TREGTISE

Njeri ndër aktivitetet kryesore ekonomike në Kosovë gjatë këtyre viteve është tregtia.Shkaqet e një orientimi kaq të madhe të bizneseve në këtë degë mund të arsyetohet nga fakte të ndryshme duke filluar nga ambienti i cili ekziston për biznese, rregullativa ligjore dhe aspekte tjera të ekonomisë.Mund të konkludojmë që tregtia luan një rol shumë dominant në orientimin e zhvillimit ekonomik dhe në krijimin e vlerës së shtuar.Shikuar numrin e bizneseve të regjistruara sipas seksionit të aktivitetit nëpër komuna vërehet se numri më i madh i këtyre bizneseve është pikërisht në



sektorin e tregtisë. Mungesa e një strategjie të zhvillimit të përgjithshëm ekonomik. Kjo ka ndikuar në nivelin shumë të ulët të mbulimit të importit me eksport:

5.7.1 POLITIKA TREGTARE E KOSOVËS



Tregtia e jashtme konsiderohet si një nga mekanizmat kryesor të rritjes në Kosovë. Për këtë arsye politika tregtare mbetet një nga instrumentet kryesore të politikës së përgjithshme ekonomike. Aspekti fundamental në politikën tregtare të Kosovës është orientimi drejt liberalizimit. Anëtarësimi në mekanizmat regjional dhe më gjerë të lehtësimit të tregtisë ndërkombëtare është një nga prioritetet e politikës ekonomike në Kosovë. Zgjerimi i tregtisë përmes liberalizimit kërkon realizimin e një numri aspektesh, si: racionalizimi dhe zëvendësimi i importeve, lehtësimi i tregtisë së jashtme, dhe promovimi i eksportit. Kjo qasje njihet si strategji e integruar e eksportit e cila i jep rëndësi të barabartë ngritjes së nivelit të konkurrencës si në tregun e jashtëm ashtu edhe në atë të brendshëm. Mirëpo, liberalizimi si i vetëm nuk mjafton të krijojë efekte gjithëpërfshirëse ekonomike.

Kosova ka deficit tregtar negativ permanent qysh nga viti 2001 e këndeje. Sipas viteve gjendja është si vijon: 2007~ -1,411,074, 2008~ -1,729.733, 2010~ - 1,861,769 euro.

5.8 INVESTIMET E JASHTME

Me Ligjin nr.02/L-33 Per investimet e huaja, Kosova u ofron trajtim të drejtë dhe të barabartë investitorëve të huaj dhe investimeve të tyre në Kosovë, mbrojtje dhe siguri të vazhdueshme dhe trajtimi, mbrojtja ose siguria që kërkohet nuk është në asnjë rast më i disfavorshëm se sa ai që garantohet sipas ligjit ndërkombëtar. Investitorët me këto ligj janë të mbrojtur nga nacionalizimi, ekspropriimi dhe e kanë të drejtën e bartjes së fitimeve të tyre në çdo kohë në vendet prej nga vijnë. Dy nga barrierat më kryesore janë tejkaluara me ndryshimet që kanë ndodhur vitin e kaluar. E para Kosova është shpall shtet i pavarur dhe njohur nga një numër i konsiderueshëm i vendeve botërore, dhe e dyta se është bërë zbritja e shkallëve tatimore në korporatë dhe në të ardhurat individuale.

Investimet e jashtme sipas viteve ishin si vijon: 2005-107.6 mil, 2006-294.8 mil, 2007-440.7 mil, 2008- 366.5 mil, 2009-310 mil, dhe 2010-265.2 mil. Në tremujorin e 2-të 2011 investimet e jashtme ishin prej 157 mil. Shiko tabelën në vijim:



Investimet e jashtme në RKS sipas viteve

5.8.1 KRIJIMI I NJË AMBIENTI PËR BIZNES

Duke vlerësuar se kushtet e ofruara për biznes në vitet paraprake ishin jo të favorshme dhe kushte të cilat nuk e bënë ekonominë kosovare joshëse për investime të jashtme, gjatë vitit 2008 dhe më vonë disa ministri u motivuan që të ndërmarrin hapa në ndryshimin e gjendjes ekzistuese. Ekonomia vendore zhvillohej ngadalë, me vështirësi dhe klima ekzistuese nuk premtonte ndonjë nxitje më të hovshme. Në anën tjetër, vendet rajonale kishin ndërmarr hapa që të ndryshonin ambientin për biznes dhe të tërheqin investimet e jashtme, dhe në këtë drejtim Kosova ngeci si një vend më pak atraktiv se sa vendet në fqinjësi. Disa faktorë bazë që ndikojnë në klimën për zhvillimin normal të biznesit siq janë: energjia, politikat fiskale, qasja në financa, infrastruktura fizike kanë treguar një përmirësim të dukshëm kohëve të fundit.

5.8.2 ENERGJIA

Sektori energjetik me disa përmirësime të vogla gjatë vitit 2008, pothuajse mbeti pandryshueshem dhe i paqëndrueshëm. Energjia ishte njëri nga faktorët kryesor i cili ndikoi negativisht në investime më të ulëta në sektorin e prodhimit apo në sektorët të cilët kanë varshmëri të madhe nga energjia elektrike.

5.8.3 INFRASTRUKTURA FIZIKE

Infrastruktura ekzistuese nuk zvogëlon kostonë dhe nuk lehtëson transportin e lëndëve të para dhe mallrave duke pasur parasysh rrugët e ngushta dhe që rrugët e reja nuk kanë treguar kualitetin e duhur. Mungesa e infrastrukturës moderne rrugore, hekurudhës funksionale, ujit, kanalizimeve, impianteve për trajtimin e ujërave të zeza,



internetit, rrjetit kualitativ për bartjen dhe shpërndarjen e energjisë elektrike etj, janë faktorë që i dekurajojnë investitorët për të investuar në Kosovë.

5.8.4 POLITIKA FISKALE

Viti 2008 sa i përket ambientit për biznes filloi me disa iniciativa dhe punë konkrete në përmirësimin, përkatësisht ndryshimin e disa rrethanave ekonomike. Kështu, pas një periudhe të gjatë të presioneve dhe kërkesave për reformë të politikës fiskale nga ana e komunitetit të biznesit në krye me OEK-un, qeveria morri vendim që të ndryshojë normat tatimore për korporata, në të ardhura personale dhe TVSH-ne. Në vitin 2008 u morr vendimi për ndryshimin e normave tatimore si në vijim:

- Tatimi në korporata nga 20% në 10%;
- Tatimi në të ardhura personale nga 0,5, 10 dhe 20% në 0,4,8 dhe 10%;
- TVSH-ja nga 15% në 16%;

Normat e reja hynë në fuqi që nga 01 Janari 2009, këto ndryshime ndikojnë në zgjerimin e bazës së tatimpaguesve kosovar, në tërheqjen e investitorëve të rinj dhe gradualisht edhe në mbushjen e buxhetit të Kosovës.

5.8.5 QASJA NË FINANCA

Edhe pse viti 2008 sipas disa parashikimeve, do të duhej të fillonte me uljen e normave kamatore për shkak të konkurrencës bankare, megjithatë kjo nuk ndodhi në praktikë. Përpos kësaj, në pjesën e dytë të vitit filloi edhe kriza financiare globale e cila nuk preku direkt sektorin bankar në Kosovë mirëpo krijoi parakushte që edhe në të ardhmen të vazhdohet me ofrimin e kredive me kushte të njëjta në mos edhe më të pavolitshme.

5.8.6 SUNDIMI I LIGJIT DHE LEGJISLACIONI

Përkundër hartimit të shumicës së ligjeve që kryhet në pajtim me standardet, kërkesat dhe legjislacionin evropian, megjithatë ky sektor vlerësohet si sektori më i dobët, më i brishtë, joefikas dhe me kapacitete të pamjaftueshme profesionale në procesimin e lëndëve kontestimore




5.9 NDËRMARRJE TË REJA NË PRISHTINË DHE KOSOVË TË THEMELUARA GJATË VITEVE 2005-2011

Periudha	Numri i Ndërmarrjeve	Përqindja %
2005	10853	19.82
2006	7099	12.97
2007	6124	11.19
2008	7557	13.80
2009	7505	13.71
2010	7729	14.12
2011	7879	14.39
TOTAL:	54746	100.00

Ndërmarrjet e reja të regjistruara në Kosovë sipas viteve 2005-2011

Prej vitit 2005 e këndeje janë themeluar në Kosovë 54,746 biznese. Vetëm në vitin 2005 janë themeluar afër 20% prej tyre. Në vitet tjera numri i bizneseve të reja të themeluara ka qenë përafërsishtë i barabartë sipas viteve.

Tabela 4



Në tabelën 4 shifet në formën grafike themelimi i ndërmarrjeve të reja sipas numrit dhe viteve. Bëmi i vërtetë ishte në vitin 2005 me 10,853 biznese të reja të themeluara.



Rangimi i ndërmarrjeve sipas veprimtarive në Kosovë, të regjistruara në 2011

Tabela 5

No	Veprimtaria	Numri	%
1	Tregtia me shumicë dhe pakicë, Riparim Autom.	2974	37.75
2	Hoteleri, Restorante	812	10.31
3	Transport, Depo dhe Telekomunikacion	806	10.23
4	Industria Përpunuese	770	9.77
5	Pasuritë e Patundshme	652	8.28
6	Ndërtimtaria	633	8.03
7	Bujqësia, Gjuetia , Pylltaria	325	4.12
8	Aktivitete tjera	907	11.51
	TOTALI:	7879	100.00

Vendin e parë për nga numri i bizneseve të regjistruara e merr tregtia me shumicë dhe pakicë me 37.75%, mandej Hotele/ Restorante 10.31% , pason veprimtaria e Transportit dhe Depove me 10.23% etj.

Rangimi i ndërmarrjeve kryesore në Kosovë dhe Prishtinë, të regjistruara në TM4-2011

Tabela 6

No	Veprimtaria	Nr. Ndr. RKS	Nr. Ndr. PR	Raporti Pr/RKS
1	Tregtia me shumicë/ pakicë, Rip.Aut.	675	169	25.04
2	Ndërtimtaria	188	17	9.04
3	Transport, Depo dhe Telekomunikacion	184	52	28.26
4	Hoteleri, Restorante	166	39	23.49
5	Pasuritë e patundshme	145	70	48.28
6	Industria përpunuese	128	24	18.75
7	Bujqësia, Gjuetia , Pylltaria	84	21	25.00
8	Aktivitete tjera	229	100	43.67
	TOTALI:	1799	492	27.35

Strukturë po thuaj e njëjtë është edhe në Prishtinë, tregtia zë vendin e parë. Prishtina zë një përqindje të madhe ndaj Kosovë me biznese të regjistruar në TM4-2011. Në tregti PR ka 25.04 % të bizneseve, në pasuri të patundshme madje 48.28% dhe hoteleri/restorante 23.49%.

Struktura e ndërm. sipas veprimtarisë të them. në Kosovë dhe Prishtinë në TM4-2011

Tabela 7

Lloji i ndërmarrjes	Nr.Nderm. RKS	% P/SH	Nr.Nderm. PR	% P/SH	Raporti PR/RKS
Ndërmarrje prodhuese	410	22.79	102	20.73	24.88
Ndërmarrje shërbyese	1389	77.21	390	79.27	28.08
TOTALI:	1799	100.00	492	100.00	27.35

Sipas tabelës së mësipërme shifet se struktura e ndërmarrjeve sipa veprimtarisë të krijuara në Kosovë gjatë TM4 është në disproporcion të lartë në raport 77.21% me 22.79 % në favor të ndërmarrjeve shërbyese ndaj atyre prodhuese. Gjë që është një



trend shumë i disfavorshëm krahasuar me nevojat e ekonomisë së Kosovës. Për Prishtinë është afërsisht e njëjta gjendje.

Klasifikimi i ndërmarrjeve sipas madhësisë në Kosovë TM4-2011

Tabela 8

Klasifikimi	Nr. i të punësuarve	Nr. iNdërmarrjeve	Përqindja %
Mikrondërmarrje	1-9	1781	99.00%
Ndërmarrje të vogla	10-49	17	0.94
Ndërmarrje të mesme	50-249	1	0.06
Ndërmarrje të mëdha	250 e mbi	0	0.00
TOTALI:		1799	100.00%

Vetëm gjatë TM4-2011 në Kosovë u regjistruan 1799 biznese prej kësaj 1799 mikrobiznese, 17 biznese të vogla. Gjatë këtij tremujori u themelua vetëm një biznes i mesëm me numër të punësuarve prej 50-249.

5.10 ZONAT EKONOMIKE

Janë hapësirat dhe objekte të përshtatshme fizike (vende apo ndërtesa me infrastrukturë të qëndrueshme) në një ambient të kontrolluar dhe menaxhuar mirë, në një lokacion të përshtatshëm, i cili është një element shumë i rëndësishëm në çdo program për zhvillim të ndërmarrjeve të një vendi.

5.10.1 LEGJISLACIONI PËR ZONAT EKONOMIKE NË KOSOVË-

Vetëm pas qershorit të vitit 1999 në Kosovë filloi ndërtimi i një legjislacioni të mirfilltë për zhvillimin e biznesit mbi bazën e filozofisë së një ekonomie të lirë të udhëhequr nga forcat e tregut. Fillimisht Rregulloret dhe Urdhëresat e UNMIK deri në shpalljen e pavarësisë së vendit me 17 shkurt 2008 përbënin bazamentin ligjor të aktiviteteve biznesore në Kosovë.


Pas 17 shkurtit 2008 Kuvendi i Kosovës filloi nxjerrjen e ligjeve të cilat përbëjnë një bazë të qëndrueshme dhe të pranueshme për zhvillim më të madh të biznesit në Kosovë.

5.10.2 ZONA EKONOMIKE NË PRISHTINË

Pozicioni Gjeografik e Zonës Ekonomike në Prishtinë gjendet përballë magjistrales Prishtinë-Mitrovicë e cila në të ardhmen do të paraqes një njësi të integruar. Zona do të ofrojë sipërfaqe toke, plan rregullues dhe urbanistik të sipërfaqeve rreth 600 ha. Menaxhimi i kësaj Zone do të jetë konform Ligjit mbi Zonat Ekonomike.

Dobishmëria Ekonomike

Dobia ekonomike e ndërtimit të Zonës Ekonomike do ishte e shumëfishtë. Nëse supozohet shfrytëzimi i plotë i kapacitetit të saj, me hapjen e vendeve të reja të punës, ngritje të ekonomisë në të gjithë sektoret e zhvillimit ekonomik të Prishtinës në përgjithësi dhe Kosovës në veçanti. Këtij fakti duhet patjetër t'i shtohet edhe ngritja e standardit jetësor në komunën e Prishtinës.



Qëllimet

- Krijimi i një ambienti fizik për bizneset vendore dhe ndërkombëtare,
- Tërheqja e investime të reja (vendore dhe të huaja),
- Grumbullimi i bizneseve në vende të përshtatshme për të bërë biznes,
- Zgjerimin industrisë ekzistuese Zhvillimi i lokaliteteve të caktuara

Shërbimet që ofrohen

- Parcela të gatshme për akomodim;
- Qira e shkallëzuar;
- Qasje e lehtë dhe hapësirë për parkim;
- Siguri e plotë;
- Qasje në rrymë, ujë, gas, telefoni, internet, nxemje, etj

Aktivitetete Kryesore

- Vendosja e bizneseve në "Zonën Ekonomike";
- Menaxhimi dhe kontrolla e tyre;
- Mirëmbajtja e kesaj zone

Rezultatet e pritura

- Hapësira më të mëdha për bizneset kosovare,
- Kushte më të mira për afarizëm të ndërmarrjeve,
- Shërbime të afërta dhe cilësore të biznesit,
- Shtimi i investimeve,
- Zhvillim i regjionit të Prishtinës,
- Rritje e numrit të punësuarve, etj.

Indikatorët e suksesit


- Kompletimi i infrastrukturës;
- Plotësimin e parcelave të lira me biznese (vendore dhe ndërkombëtare);
- Ngritja e kapaciteteve prodhuese dhe përmirësimi i pozitës në treg të prodhuesve vendorë,
- Ulja e papunësisë, etj.

5.10.3 PLANIFIKIMI ZONËS EKONOMIKE

Pas analizave finale procesi i planifikimit të zones ekonomike involvon së pari planifikimin e tokës, disajnin e nëndarjeve dhe ngastrimin dhe percaktimi i punishteve individuale, ndertimi i rrugeve, ndërtimet infrastrukturore dhe pejsazhimin e pergjithshëm.

Riparcelimi/Ngastat e reja-Është preliminarë dhe paraqet shenjimin e rrugëve dhe ndarjet e parcelave. Ngastra paraqet karakteristikat aktuale ose të planifikuara siç janë rrugët apo trojet e ndërtesave, ato në këtë plan janë prezentuar si propozim të cilat gjatë zgjidhjes së blloqeve mund edhe të ndryshojnë.

